



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA
DREJTORIA E MENAXHIMIT, PROJEKTEVE DHE MONITORIMIT
SEKTORI I PROJEKTEVE

Lënda: Analizë e realizimit të detyrave për vitin 2016

KËTU

Në zbatim të Programit Strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm 2015-2020, Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura, si dhe Planit të detajuar të punës për zonat e mbrojtura, të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në lidhje me punën e kryer nga data 01.01.2016 deri më datë 31.12.2016 ju informojmë se:

Sektori i Menaxhimit

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2016 u përball me sfida dhe probleme të shumta, mbartur nga viti 2015 siç ishin;

- Kontratat e punimeve lidhur me ish- DRSHP-të, llojet e veprimtarive, baza ligjore e lejueshmërisë, likuidimi financiar i tyre.
- Dhënia e mendimit për zhvillimin e veprimtareve brenda territoreve të zonave të mbrojtura, kërkuar nga subjekte të ndryshme që kanë zhvilluar dhe kërkojnë të vazhdojnë të kryejnë veprimtari të ndryshme ekonomike e turistike në zonat e mbrojtura si dhe subjekte që kërkojnë për herë të parë të zhvillojnë veprimtari të lejuara.
- Ndërhyrjet e paligjshme në fondin pyjor/kullor si: prerje të pemëve, dëmtimi i tyre nga fenomene natyrore si shkulje, thyerje e tharje, dëmtim nga insektet dëmtues apo patologji e sëmundje të ndryshme, ndërtime të paligjshme, procesi i sekuestrimit të materialit drusor, gjetja e rrugëve për një menaxhim të qëndrueshëm të tyre.

Ndodhur para një vakumi ligjor, sektori i menaxhimit për gjetjen e zgjidhjeve në mënyrë që brenda territorit të zonave të mbrojtura të vazhdonte puna për zhvillimin e veprimtarive të lejuara

në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme i propozuan Drejtorit të Përgjithshëm që AKZM nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit ti paraqesë Këshillit të Ministrave një Amendim në VKM nr. 102, datë 04.02. 2015 “Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit e të organizimit të AKZM-së dhe të AdZM-ve në qarqe”, që AKZM dhe strukturat vartëse të saj në qarqe të ketë të drejtë të lidhë kontrata për veprimtaritë që lejohen të zhvillohen në zonat e mbrojtura si dhe të zgjidhë ato kontrata që janë lidhur nga ish-DRSHP-të në kundërshtim me ligjin nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e Mbrojtura” të ndryshuar.

Me realizimin e këtij amendimi AKZM dhe AdZM-të në qarqe tashmë kanë aksesin të operojnë me subjektet në territorin e zonave të mbrojtura.

Pas realizimit të këtij amendimi sektori i menaxhimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe të Shërbimeve të Brendshme i propozuan Drejtorit të Përgjithshëm ngitjen e një grupi pune me përfaqësues nga të gjithë AdZM-të, i cili do të shqyrtonte me hollësi të gjitha kontratat e lidhura dhe të përcaktonte se cilat kontrata ishin konform ligjit të zonave të mbrojtura dhe cilat jo. Kjo detyrë nuk u përmbush në kohë pasi pati mos rakordim ndërmet grupit të punës dhe sektorëve të menaxhimit në qarqe.

Ndërkohë sektori i menaxhimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme përgatiti dhe procedurën që duhet të ndiqet nga AdZM-të për rastet kur subjektet kërkojnë zhvillim të veprimtarive të lejuara në territorin e zonave të mbrojtura. Për këtë u hartua dhe u miratua Urdhëri i Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 “Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura”.

Po kështu në bashkëpunim me drejtorinë juridike të MM, u diskutua dhe u saktësua procedura teknike për ushtrimin e veprimtarisë për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të kullotave në zonat e mbrojtura, kjo në zbatim të nenit 25 të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” të ndryshuar, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.4, datë 10.04.2008 “Mbi caktimin e kriterëve teknike dhe procedurave të dhënies për kullotje dhe kositje bari”.

Referuar këtyre akteve ligjore, u përgatit Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm “Për procedurat e dhënies për kullotje dhe kositje bari të sipërfaqeve kullimore në zonat e mbrojtura”.

U miratua kontrata tip “Për dhënien në përdorim të sipërfaqeve kullimore në zonat e mbrojtura”

U miratuan parcelat kullimore dërguar nga AdZM-të, klasifikuar sipas kategorisë së zonës mbrojtur, sipërfaqet dhe kapacitetit mbajtës të tyre.

U miratuan dokumentat bazë që duhet të plotësohen nga sektorët e menaxhimit gjatë lidhjes së kontratave.

Kështu gjatë vitit 2016, kjo veprimtari u zhvillua në disa sipërfaqe kullimore të zonave të mbrojtura që gjenden në PK, RNM e PM dhe konkretisht:

AdZM-ja Berat ka lidhur gjithsej 13 kontrata dhe konkretisht:

Në PK “Mali i Tomorrit”, në ekonominë “Mali i Tomorrit” janë lidhur kontrata në parcelat kullimore, nr. 19/a,/b, 24.b, 35/a, 56/a, 82/a, 83/b, 107/c, 119/b, dhe 123/b me sipërfaqe totale prej 192.4 ha.

Në PK “Mali i Tomorrit”, në ekonominë “Mali i Dardhës” janë lidhur kontrata në parcelat kullimore, nr.4/1 dhe 7 me sipërfaqe totale prej 129.7 ha.

Në PK “Mali i Tomorrit”, në ekonominë “Hija e Roshnikut” janë lidhur kontrata në parcelat kullimore, nr. 4/2, 8, 137/b, 138/a dhe 139/b me sipërfaqe totale prej 288.5 ha.

Në PK “Mali i Tomorrit”, në ekonominë “Tomorricë” janë lidhur kontrata në parcelat kullimore, nr. 15 dhe 21 me sipërfaqe totale prej 209.0 ha.

AdZM-ja Dibër ka lidhur gjithsej 6 kontrata dhe konkretisht:

Në RNM/ PN “Korab - Koritnik”, në ekonominë “Gramë” janë lidhur kontrata në parcelat kullimore, nr. 13 dhe 20 me sipërfaqe totale prej 117.0 ha.

Në RNM/ PN “Korab - Koritnik”, në ekonominë “Serjan - Kërçisht” janë lidhur kontrata në parcelat kullimore, nr. 21 me sipërfaqe totale prej 60.0 ha.

AdZM-ja Elbasan ka lidhur gjithsej 23 kontrata dhe konkretisht:

Në PK “Shebenik - Jabllanicë”, në ekonominë “Qarrishtë” janë lidhur kontrata në parcelat kullimore, nr. 2, 3, 4, 10, 12, 13, 17, 22 dhe 39/2 me sipërfaqe totale prej 467.5 ha.

Në PK “Shebenik - Jabllanicë”, në ekonominë “Rrajcë” janë lidhur kontrata në parcelat kullimore, nr. 3, 4, dhe 13 me sipërfaqe totale prej 85.2 ha.

Në PK “Shebenik - Jabllanicë”, në ekonominë “Stëblevë” janë lidhur kontrata në parcelat kullimore, nr. 51/b me sipërfaqe 35.0 ha.

AdZM-ja Gjirokastrë ka lidhur gjithsej 7 kontrata dhe konkretisht:

Në PK “Bredhi i Hotovës - Dangëlli”, në ekonominë “Petran - Çarçovë” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 6, 7, 8, 9 dhe 10 me sipërfaqe totale prej 595. 0 ha.

Në PK “Bredhi i Hotovës - Dangëlli”, në ekonominë “Petran - Zavalan” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 49/a,b, 55/a, 59/a, 60, 61, 62, 63, 64, 66, 67, 68, 69, 70, 174, 176, 182, 210, 212, 213, 214 dhe 215 me sipërfaqe totale prej 721. 0 ha.

Në PK “Bredhi i Hotovës - Dangëlli”, në ekonominë “Lamniu” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 149, 150, 151/a,b me sipërfaqe totale prej 112.5 ha.

Në PK “Bredhi i Hotovës - Dangëlli”, në ekonominë “Dangëlli” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 65, 66, 67, 73, 76, dhe 77 me sipërfaqe totale prej 152. 0 ha.

AdZM-ja Korçë ka lidhur gjithsej 19 kontrata dhe konkretisht:

Në PK “Prespë”, në ekonominë “Qafë Zezë - Trestenik” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 43/a,b, 45, 46, 47a,b, 72, 76 a, 80/b, 81/a, 93, 95, 96/a,b, me sipërfaqe totale prej 435. 0 ha.

Në PM “Liqeni i Pogradecit”, në ekonominë “Qafë Zezë - Trestenik” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 14a, 16d, 17a,c,d, 18a, 19a, 21a,c, me sipërfaqe totale prej 255. 0 ha.

Në ZMBM “Piskal - Shqerri”, në ekonominë “Piskal - Shqerri” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 7, 10, 16, 17, 18, 19, 20, 27, 28, 36 me sipërfaqe totale prej 921. 0 ha.

Në ZMBM “Guri i Nikes”, në ekonominë “Nicë - Valamarë” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 13, 14, 15, 17, 18, 19, 20 me sipërfaqe totale prej 614. 0 ha.

AdZM-ja Tiranë ka lidhur gjithsej 22 kontrata dhe konkretisht:

Në PM “Mali me Gropa – Bizë - Martanesh”, në ekonominë “Linos - Brozh” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 me sipërfaqe totale prej 578. 0 ha.

Në PK “Mali i Dajtit”, në ekonominë “Mner Bastar - Shëmri Selitë” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 2, 6, 7, 8 me sipërfaqe totale prej 422.3 ha.

AdZM-ja Vlorë ka lidhur gjithsej 33 kontrata dhe konkretisht:

Në RNM “Karaburun”, në ekonominë “Karaburun” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore 10, 14, 17, 18, 19, 20,21, 22, 25, 28, 29, 31, 32, 34, 36, me sipërfaqe totale prej 594.0 ha.

Në RNM “Karaburun”, në ekonominë “Ana e Detit” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 1, 19, 20, 25, 31, 32, me sipërfaqe totale prej 250.0 ha.

Në PK “Butrint”, në ekonominë “Aliko - Mile” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 7, 8, me sipërfaqe totale prej 110.0 ha.

Në PK “Butrint”, në ekonominë “Mile - Stillo” janë lidhur kontrata në parcelat kullosore, nr. 2, 3, 8, 14, 15, 17, 18, me sipërfaqe totale prej 242.0 ha.

Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 “Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura” , gjatë vitit 2016 pranë AdZM-ve nga subjekte të ndryshëm janë paraqitur kërkesa të ndryshme për zhvillim veprimtarish të lejuara brenda territorit të zonave të mbrojtura dhe konkretisht:

AdZM-ja Lezhë ka pranuar dhe shqyrtuar 2(dy) kërkesa nga subjekte apo individë për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontrata për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në RNM “Kune – Vain – Tale” në parcelën nr. 6 të ekonomisë pyjore Shëngjin – Tale, në zonë Rekreative, ka vlerësuar se është dakort për zhvillimin e veprimtarisë “Instalim njësive portative prej druri”, sipërfaqen prej 1500 m² .

Në RNM “Fushë Kuqe – Patok – Ishëm” në parcelën nr. 6/b të ekonomisë pyjore Fushë Kuqe, në zonë të përdorimit të qëndrueshëm me bmësi ujore, ka vlerësuar se është dakort për zhvillimin e veprimtarisë “Instalim njësive portative prej druri”, sipërfaqen prej 10000 m² .

AdZM-ja Tiranë ka pranuar dhe shqyrtuar 2(dy) kërkesa nga subjekte të ndryshëm për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontrata për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në PK “Mali i Dajtit” në parcelën nr. 53, të ekonomisë pyjore Dajt, klasifikuar si zonë rekreative natyrore e nivelit 2 dhe shënuar në hartë me ZR2, ka vlerësuar se është dakort për zhvillimin e veprimtarisë” Krijim piste për fluturime të lira me vela pa motorr” me sipërfaqe 0.06 ha.

Në PM “Mali me Gropa – Bizë – Martanesh” , në parcelën nr. 77/d të ekonomisë pyjore Vërri, klasifikuar si zonë e zhvillimit të qëndrueshëm (ZPQ), ka vlerësuar se është dakort për

zhvillimin e veprimtarisë “Instalim njësi portative prej druri për aktivitet turistik” me sipërfaqe 0.1 ha.

AdZM-ja Fier ka pranuar dhe shqyrtuar 1 (një) kërkesë nga një subjekt për zhvillimin e veprimtarive të lejuara në zonat e mbrojtura dhe ka lidhur kontratë për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje dhe konkretisht:

Në PK “Divjakë - Karavasta” në ekonomisë pyjore Pisha Divjakë, Graxhisht dhe Gjinarukë, klasifikuar si zonë përdorimit të qëndrueshëm (ZPQ), ka vlerësuar se është dakort për zhvillimin e veprimtarisë “Vjelje dhe grumbullim të boçeve të pishës së butë” me sipërfaqe 1250 ha.

Spektori i menaxhimit në zbatim të Urdhërit të MM Nr. 129, datë 23.06.2016 “Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura” dhe plotësimit të kriterëve sipas Aneksit të këtij urdhëri që duhen përmbushur nga AdZM-të dhe subjekti kërkuar, i ka shqyrtuar e analizuar me hollësi kërkesat e paraqitura duke iu referuar vlerësimit të AdZM-së dhe specifikave teknike që ka kërkesa e subjektit dhe kur e ka vlerësuar pozitiv kërkesën, ka përgatitur MEMO-n përkatëse dhe Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm për miratimin e lidhjes së kontratës nga AdZM-ja.

Spektori i menaxhimit gjithashtu ka kërkuar që kjo rrugë të ndiqet dhe për rastet e kontratave që janë në vazhdim (kontratat e mbartura nga ish-DRSHP-të), ku AdZM-të të rivlerësojnë gjithë dokumentacionin e sjellë nga subjekti si dhe kontratën nëse veprimtaria që kryen subjekti është veprimtari e lejuar duke iu referuar bazës ligjore që buron nga Urdhëri i Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016. Po kështu në bashkëpunim me drejtorinë e financës dhe shërbimeve të brendshme dhe AdZM-të përkatëse është kërkuar të kontrollohen pagesat vjetore, likuidimi financiar i kontratës për çdo vit dhe detyrimet e pa paguara, detyrë e kërkuar dhe nga auditi i KLSH-së. Janë urdhëruar AdZM-të që ta ndjekin vazhdimisht këtë problem. Për realizimin dhe ndjekjen e kësaj detyre u përgatit Urdhëri i Drejtorit të përgjithshëm nr. 557, datë 30.05 2016 “Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të lidhura me ish-DRSHP-të dhe vazhdim”. Për zbatimin e këtij urdhëri u ngrit grupi i punës me përfaqësues nga të gjitha AdZM-të dhe koordinatorë znj. Nurie Visha, e cila ka ndërtuar një databasë dhe ka përgatitur informacionin për të gjitha kontratat që ishin lidhur nga ish-DRSHP-të, sipas llojit të veprimtarisë, zonës së mbrojtur, afatin kohor, vlerën totale të saj, sasinë e likuiduar dhe diferenca financiare e pa likuiduar.

Gjatë monitorimit dhe verifikimeve nga AdZM-të janë konstatuar dhe subjekte të cilët kryjnë veprimtari për nxjerrje minerali të kromit në PK “Shebenik – Jabllanicë” ku tashmë po kërkojnë

të lidhin kontrata. Lidhur me këtë problem kemi diskutuar vazhdimisht dhe me sektorin e menaxhimit të AdZM-së Elbasan. Ky problem do të marrë rrugë zgjidhje gjatë këtij viti.

Për kryerjen e detyrave të tyre funksionale dhe për një prezantim sa më dinjitoz stafi i AdZM-ve kishte nevojë përveç infrastrukturës së ambjenteve të punës, mjeteve motorike edhe për uniforma ku të identifikoheshin institucioni që përfaqësojnë. Për shkak të mungesës së bazës ligjore me amendimin e VKM-së nr. 102, datë 04.02.2015 u bë e mundur të parashikoheshin dhe pajisja me uniformë dhe armë e mjete ndihmëse të stafit të AdZM-ve. Nga sektori i menaxhimit u përgatit draft Urdhëri i Ministrit të Mjedisit që përcaktonte në mënyrë të detajuar modelin e uniformave dhe mbajtjen e tyre.

Bazuar në Urdhërin e Ministrit të Mjedisit nr. 615, datë 03.06.2015, AKZM ka qenë pjesë e Grupit Ndërinstitucional kundër Krimin Mjedisor (GNKM), ku marrin pjesë institucione të ndryshme shtetërore, dhe do të hartohen dokumente strategjike dhe do të firmoset një protokoll për ndarje informacioni.

- ❖ Detyrë tjetër, sektori i menaxhimit gjatë vitit 2016, ka shqyrtuar dhe analizuar, kërkesat dërguar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dërguara në rrugë elektronike për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme në territorin e zonave të mbrojtura. Dhëniet e mendimit janë përgatitur bazuar në ligjin nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura” të ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore si VKM-së së shpalljes së zonës së mbrojtur, zonimit të brendshëm e planit të menaxhimit, bazuar në strategjinë kombëtare për zonat e mbrojtura, zhvillimit për një menaxhim të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe së fundmi dhe PPV të bashkive.

Gjatë vitit 2016 janë përgatitur përgjigje për “Dhënie Mendimi” gjithsej 103 raste nga këto:

- Aktiviteti i nxjerrjes së mineraleve (miniera): 10,
- Gurore dhe karriera: 18,
- Ndërtime resortesh, bar-restorante, kapanone: 12,
- Ndërtim HEC-e dhe Rivënie në punë të HEC-e: 21,
- Ndërtim aksesh rrugore dhe rikonstruksione rrugësh dhe pika kalimi: 5,
- Ndërtim fabrike për bolitimin e ujit, vënie impiantesh dhe mendime mbi strtegjinë e ujit: 5,
- Ndërtim kompleksi blegtoral, kapanone bujqësore, projekte agropylltarie, kompleks pularie etj: 5,
- Pritë mbajtëse e kanalit të shkëmbimit të ujit Lagunë-Det-Lagunë: 1,

- ❖ Në kuadër të krijimit të bashkive të reja dhe transferimit të fondit pyjor/kullosor me VKM nr. 433, datë 06.08.2016 u konstatua se disa parcela të ekonomi pyjore/kullosore që janë në zonë të mbrojtur i kishin kaluar bashkive respektive apo dhe raste parcelash kur nuk janë të zonës së mbrojtur sipas formularit nr. 4 po nuk janë pasqyruar dhe në listat e transferimit të bashkive të reja sipas VKM-së 433, datë 06.08.2016.

Ndodhur para këtij fakti, Drejtorit të përgjithshëm iu propozua të krijohet një grup punë me përfaqësues të të gjithë AdZM-ve dhe kordinatore në AKZM znj. Merita Ceka, për të zgjidhur këto parregullësi. Me Urdhërin nr. 667, datë 16.06. 2016 të Drejtorit të Përgjithshëm, grupi i punës u ngarkua që të koordinojë punën për saktësimin, përditësimin dhe rregjistrimin e të dhënave kadastrale të ZM dhe të bashkëpunojë me zyrën e kadastrës pranë Ministrisë së Mjedisit. Grupi i punës (përfaqësuesi i çdo AdZM-je) ka raportuar për gjendjen që ekziston për të dhënat kadastrale të zonave të mbrojtura që administrojnë e menaxhojnë dhe kanë punuar me koordinatoren duke i saktësuar e rakorduar parcelat pyjore/kullosore sipas formularit nr. 4 të plotësuar nga specialistët e AdZM-ve me atë të transferuar bashkive të reja sipas VKM-së 433, datë 06.08.2016. Gjithashtu po punohet dhe për saktësimin e hartave pyjore ekzistuese me ato të gjeoreferuara Kjo detyrë do të vazhdojë edhe gjatë këtij viti dhe në kuadër të inventarit kombëtar të fondit pyjor/kullosor që do të realizohet, në përbërje të grupeve të punës në terren do të jenë dhe përfaqësuesit tanë të AdZM-ve.

- ❖ Në zbatim të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 667, datë 16.06. 2016 “Për mbajtjen, përdorimin, dhe rregjistrimin e të dhënave kadastrale të zonave të mbrojtura”, pranë sektorit të menaxhimit janë paraqitur specialistët e AdZM-ve, që janë ngarkuar për mbajtjen, rregullimin dhe saktësimin e sipërfaqeve kadastrale të zonave të mbrojtura duke koordinuar e krahasuar të dhënat kadastrale të formularit nr. 4 për zonat e mbrojtura me të dhënat (parcelat pyjore/kullosore), transferuar pranë bashkive të reja.

Gjatë punës është konstatuar se ka raste ku parcela të ekonomive pyjore/kullosore janë të mbivendosura, apo sipërfaqja totale e zonës së mbrojtur sipas VKM-së së shpallur nuk rrezulton e tillë, pasi ka mbi vendosje të tyre punuar sipas hartave të ekonomive pyjore. Ndodhur para kësaj gjendje po punojmë duke saktësuar hartat e këtyre ekonomive me hartën e zonës së mbrojtur të miratuar. Duke bërë përputhjen e tyre janë vërejtur probleme si:

Në hartën e PK “Mali i Dajtit” ka mospërputhje të vijës kufitare me bashkinë Tiranë ku disa nga ngastrat e Ek Pyjore që i përkasin PK, janë transferuar bashkisë dhe disa ngastra që i janë jashtë kufirit të parkut nuk , janë trasferuar bashkisë, mbeten pjesë e parkut.

Në hartën e PM “Mali me Gropa Bizë Martanesh” ka mospërputhje ku pothuajse të gjitha ngastrat që i përkasin zonës së mbrojtur (AdZM-së Dibër), janë transferuar bashkisë Bulqizë dhe Klos.

Në hartën e PK “Lurë” ka mbivendosje të ngastrave të ekonomisë pyjore të PK Lurë me ekonominë pyjore Lura 1 si dhe disa ngastra të ek pyjore Lura 1 që janë brenda kufirit të zonës së mbrojtur PK Lurë janë transferuar bashkisë Dibër.

Në hartën e ZMBM “Luzni Bulac” ka mospërputhje dhe po punohet për saktësimin e përputhshmërisë me hartat e ek.pyjore “Muhurr Sinë” dhe ek.pyjore “Gjurash Mazinë” e cila i është transferuar bashkisë Bulqizë. Në këtë rast të gjitha parcelat pyjore/kullosore të kësaj ekonomie që janë në territorin e bashkisë Bulqizë por i përkasin zonës së mbrojtur (AdZM-së Dibër), janë transferuar bashkisë Bulqizë.

Bashkisa Shkodër dhe AdZM-ja Shkodër kanë rakorduar me sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor që i është kaluar bashkisë Shkodër, por nuk është rakorduar ende me bashkinë Malësia e Madhe për RNM” Liqeni i Shkodrës”, mbetet për rakordim vetëm me ek.pyjore “Gruemirë”. Po kështu AdZM-ja Shkodër për PMUT “Lumi Buna Velipojë” duhet të bashkëpunojë me AdZM-në Lezhë pasi në këtë zonë përfshihet edhe territor i bashkisë Lezhë ku të gjitha ngastrat e ekonomive pyjore dhe kullosore që i përkasin AdZM-së Lezhë i kanë kaluar bashkisë Lezhë dhe ende AdZM-ja Lezhë nuk ka dijeni për këtë.

Në hartën e RNM “Patok Fushë Kuqen Ishëm” nga verifikimi rezulton se pothuaj të gjitha ngastrat e ekonomive pyjore dhe kullosore të kësaj zone i kanë kaluar bashkisë Kurbin.

Hartat e gjeoreferuara për PM “Vjosë Narte”, PK “Butrint” dhe RNM “Rrëzomë”, dërguar AdZM-së Vlorë, ende nuk kemi përgjigje.

Hartat e gjeoreferuara për PK “Bredhi i Hotovës Dangëlli” dhe RSN “Kardhiq”, dërguar AdZM-së Gjirokastrë, ende nuk kemi përgjigje.

Harta e gjeoreferuar për PK “Shebenik Jabllanicë”, parcelat 118,119, 120, 121, të ek.pyjore “Librazhd” i janë transferuar bashkisë Librazhd dhe ka të mbivendosur disa parcela midis ek pyjore me ek.kullosore për të cilat nuk janë të hedhura të dhënat përfundimtare.

AdZM Kukës ka dërguar hartën e PN “Korab Koritnik” por ka probleme ku disa ngastra të ek.pyjore “Bicaj Kolesian” janë transferuar bashkisë Kukës dhe për ek.pyjore “Tërthore e Lumës” ngastrat 77a, b; 78a, b, c, janë transferuar bashkisë Kukës. Lidhur me pjesën tjetër të PN “Korab Koritnik” që administrohet nga AdZM-ja ende nuk ka përfunduar verifikimi.

Për PK “Divjakë Karavasta” ende nuk ka përfunduar verifikimi.

Në hartën e gjeoreferuar për PK “Mali i Tomorrit” ka disa mospërputhje si: ek.pyjore “Gulak Poliçan”, “Devri Terrovë” dhe ek kullosore “Tomorricë” pjesërisht i janë transferuar bashkisë Skrapar, ek pyjore “Mali i Tomorrit” pjesërisht i janë transferuar bashkisë Poliçan dhe ek.pyjore “Roshnik” pjesërisht i kanë kaluar bashkisë Berat.

Hartat e gjeoreferuar për PM “Liqeni i Pogradecit” dërguar AdZM-së Korçë, ende nuk ka asnjë përgjigje.

Hartat e gjeoreferuar për PK “Liqeni i Prespës” dërguar AdZM-së Korçë rrezulton se nuk ka probleme me bashkinë Pustec.

Kjo ishte në përgjithësi panorama e gjendjes kadastrale për zonat e mbrojtura, problematikat lidhur me to dhe sugjerimet e dhëna për vazhdimin e këtij procesi. Duke bashkëpunuar me specialistët e GIS-it për të realizuar përputhshmërinë e treguesve kadastralë (sipërfaqet, përbërja e grumbujve pyjor, pronësia,) etj, është një punë që duhet të ndiqet me përparësi gjatë këtij viti ku përkon dhe me procesin e Inventarizimit Kombëtar të Pyjeve në Shqipëri.

Është detyrë imediate që brenda vitit 2017 të saktësohet dhe standartizohet gjendja kadastrale për zonat e mbrojtura duke u bazuar në Udhëzimin nr. 4, datë 12.04.2008 “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor dhe Udhëzimin nr. 3, datë 03.04.2013 “Për rregullat dhe mënyrën e mbajtjes, skedimit, funksionimit dhe përdorimit të rregjistrit të zonave të mbrojtura” (apo duke iu referuar dhe ndryshimeve që mund të bëhen).

Në kuadër të bashkëpunimit dhe koordinimit të problematikave me pushtetin vendor, me porosi të Drejtorit të Përgjithshëm, sektori i menaxhimit nëpërmjet specialistit të GIS-it këtu, përgatiti dhe u dërgoi të gjitha bashkive të vendit resurset natyrore (zonat e mbrojtura (apo pjesë të tyre) dhe monumentet e natyrës) që gjenden brenda territorit të tyre. Këto të dhëna iu dërguan të gjitha bashkive me shkresa zyrtare duke u kërkuar dhe konfirmim.

Mendohet të bëhet një rishikim tërësor i zonave të mbrojtura pra do të ketë të ketë ndryshime si në status, sipërfaqe, zonim të zonave të mbrojtura po ashtu dhe të monumenteve të natyrës (MN) pasi jemi përpara miratimit të ligjit të ri të zonave të mbrojtura.

- ❖ Një detyrë tjetër që është ndjekur me përkushtim ka qënë dhe pjesëmarrja e vazhdueshme në dëgjesat publike pranë AKPT-së në kuadër të hartimit të planeve të përgjithshme vendore (PPV). Në të gjitha këto takime kemi qënë pjesëmarrës dhe kemi diskutuar, lidhur me perspektivën që do të kenë planet zhvillimore të bashkive të reja hartuar nga studiot konsulente.

Në këto takime kemi kërkuar që në këto plane zhvillimore të bashkive të merren në konsideratë:

- Ligji i zonave të mbrojtura nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” (të ndryshuar).
- VKM-të përkatëse për shpalljen e zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës.
- Kategoritë e zonave të mbrojtura (statusin e mbrojtjes).

- Zonimi i brendshëm i zonës së mbrojtur.
- Veprimtaritë e ndaluara dhe ato të lejuara brenda zonës së mbrojtur.
- Statusin e veçantë për monumentet e natyrës (MN) veçanërisht për shpellat, kanionet e hidromonumentet.

Gjatë diskutimeve kemi shprehur sugjerime dhe për zonat e mbrojtura, propozuar për tu shpallur të tilla.

Gjatë zhvillimit të këtij procesi kanë qënë prezent dhe përfaqësues të AdZM-ve ku kanë dhënë sugjerimet e tyre, duke diskutuar për raste konkrete ku mund të zhvillohen veprimtari e aktivitete të lejuara në këto zona.

Nga ana e saj AKPT si organizatore dhe drejtuese e këtij procesi ka qënë mbështetëse për ruajtjen dhe zhvillimin e natyrës dhe biodiversitetit në mjedis dhe veçanërisht për zonat e mbrojtura.

Theksojmë se në përgjithësi studiot konsulente për hartimin e këtyre planeve i kanë marrë në konsideratë sugjerimet, vërejtjet dhe mendimet tona dhe i kanë materializuar në këto plane.

Gjatë vitit 2016 nga sektori i menaxhimit me mbështetjen e specialistit të GIS-it u punua për të përcaktuar saktë disa të dhëna për çdo monument natyre (MN) dhe konkretisht:

- Vendodhja me sistem koordinatash e të gjithë MN.
- U standartizua skeda e përshkrimit të MN.
- Fotoja e tyre.

Kjo detyrë është në limitet e përmbylljes dhe në kuadër të miratimit të ligjit të ri të zonave të mbrojtura do të jetë bashkëlidhur për miratim si rrjedhojë e akteve nënligjore si: (VKM, Udhëzime, Procedura, Urdhëra etj).

- ❖ Gjithashtu me ndihmën dhe mbështetje të specialistit të GIS-it u bë e mundur evitimi i të gjithë HEC-ve që janë ndërtuar apo vazhdojnë të ndërtohen brenda territorit zonave të mbrojtura, për të cilët janë dhënë lejet konçesionare nga MEI. Kjo detyrë u realizua duke u bazuar në lejet mjedisore të lëshuara nga AKM-ja ku rrezultojnë se janë gjithsej 65 HEC-e. Por ndërkohë po dërgohen nga AKM-ja dhe raste të tjera ku subjekte të ndryshëm kanë leje konçesionare lëshuar nga MEI, për zhvillim veprimtarie “Ndërtim HEC-i”. Lidhur me këto veprime ne jemi të vendosur që çdo veprimtari që kërkohet të zhvillohet në territorin e zonave të mbrojtura të jetë e bazuar në ligjin e zonave të mbrojtura, zonimin e brendshëm, planin e menaxhimit, veprimtaritë e lejuara, në përputhje me PPV-të e bashkive dhe me objektivat e strategjisë kombëtare të zonave të mbrojtura.

Gjithashtu, nga sektori i menaxhimit në bashkëpunim me specialistin e GIS-it dhe AdZM-të është punuar për të përcaktuar saktë vendodhjen (është përcaktuar zona e mbrojtur, kategoria e saj, zonimi i brendshëm) e veprimtarisë “Nxjerrje e mineralit të kromit në zonat e mbrojtura”, të disa subjekteve që ushtrojnë këtë aktivitet bazuar vetëm në lejen minerare, pa lidhur kontrata për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqes së zonës së mbrojtur. Në dosjet e këtyre subjekteve ekziston vetëm procedura me MEI-n dhe asgjë tjetër. Nuk është hartuar Raport teknik për zonën (sipërfaqen që shfrytëzon) nga ish-DRSHP-të dhe nuk janë lidhur kontrata. Ndodhur para këtij fakti do të ndërmerret një vendim, lidhur me këtë lloj veprimtarie.

- ❖ Detyrë tjetër që u ndoq me vëmendje nga sektori i menaxhimit ishte dhe kërkesa e bërë nga disa AdZM për gjetjen e një zgjidhje ligjore “Furnizimi me dru zjarri i banorëve me banim të përhershëm që ndodhen brenda zonave të mbrojtura”.

Dihet që misioni dhe detyra kryesore e AKZM-së është ruajtja e natyrës dhe biodiversitetit në territorin e zonave të mbrojtura, por krahas konservimit, si domosdoshmëri të synohet dhe drejt një menaxhimi të qëndrueshëm të këtyre zonave. Meqenëse për disa zona të mbrojtura janë hartuar dhe planet e menaxhimit, ku përcaktohen qarët dhe saktë prioritetet që ka çdo zonë e brendshme, bëhet e mundur dhe mundësia për kryerje të disa veprimtarive që nuk çojnë në përkeqësim të natyrës e mjedisit. Gjithashtu banorët e komuniteteve që ndodhen brenda territorit të zonave të mbrojtura janë dhe konsiderohen si partner të AdZM-ve. Për shkak të Moratoriumit të Pyjeve dhe nevojës së popullatës vendase (brenda zonave të mbrojtura) për dru zjarri nga ana e AdZM-ve janë bërë kërkesa të vazhdueshme për tu furnizuar me dru zjarri. Ndodhur para një vakumi ligjor, Drejtoria e Menaxhimit, Projekteve dhe Monitorimit hartuan e propozuan draft Urdhërin, Drejtorit të Përgjithshëm për të mundësuar furnizimin me dru zjarri për banorët e fshtrave malorë në Zonat e Mbrojtura.

Me Urdhërin e Ministrit të Mjedisit nr. 190, datë 29. 09. 2016 “Për kriteret dhe rregullat e rehabilitimit dhe shëndetësimit të pyjeve në zonat e mbrojtura me qëllim plotësimin e nevojave të komunitetit të zonës me dru zjarri” u bë e mundur arritja e këtij qëllimi.

Në zbatim të këtij Urdhëri, u është kërkuar AdZM-ve që të zbatojnë me përpikmëri të gjitha kushtet dhe kriteret që burojnë nga ky urdhër.

AdZM-të që paraqitën projektet për rehabilitim të zonës pyjore (propozuar prej tyre) u shqyrtuan dhe u bë vlerësimi i tyre bazuar në kriteret teknike e silvobiologjike të sipërfaqeve pyjore.

Gjatë viti 2016 dërguan projekte “Për rehabilitimin dhe shëndetësimin e sipërfaqeve pyjore për prodhim dru zjarri”, planifikuar për furnizimin e banorëve me banim të përhershëm në zonat e mbrojtura, për shqyrtim dhe miratim AdZM-të, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë, Berat dhe Lezhë.

Pas miratimit të këtyre projekteve, sektori i menaxhimit përgatiti MEMO-n dhe Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm për zbatim dhe ndërkohë u kërkoi AdZM-ve që në përfundim të

procesit të paraqitnin një raport të hollësishëm mbi zbatimin e këtij urdhëri për punën e bërë sipas fazave të parashikuara në projekt.

Kanë paraqitur këtë raport AdZM-të, Elbasan, Korçë, pjesërisht Berat dhe *mungon Gjirokastra*.

Nga verifikimet e kryera në terren dhe materiali shkresor rrezulton që kushtet dhe kriteret e kushtëzuara në këtë urdhër janë respektuar, marrë e vlerësuar me korrektësi nga AdZM-të. Këtë proces nuk e ka filluar fare AdZM Lezhë me arsyen se banorët e këtyre fshatrave janë furnizuar me dru zjarri nga bashkia.

Në fushën e faunës së egër

Spektori i menaxhimit u ka shpërndarë AdZM-ve Manualin e metodikave të inventarizimit dhe monitorimit të llojeve të faunës së egër objekt gjuetie dhe Urdhërin e Ministrisë nr. 01., datë 11.02.2016. Gjithashtu u janë shpërndarë dhe draft udhëzimi dhe protokollet e terrenit për inventarizimin e shpendëve folezues. Në kuadër të “Inventarit për sistemin e monitorimit të faunës së egër” nëpërmjet INCA-s, nga sektori i menaxhimit është ngarkuar një specialist i cili do të jetë personi i kontaktit dhe që do të ndjekë në vazhdimësi gjithë procesin e inventarizimit të faunës së egër, duke mbajtur dhe të dhënat përkatëse. Në këtë kuadër u organizuan disa trajnime me përfaqësues të të gjitha AdZM-ve, veçanërisht për inventarin e shpendëve ujorë. Ky proces do të vazhdojë gjatë gjithë vitit 2017.

U ndoq dhe procesi i marrjes së kampioneve të dhelprës së kuqe në zbatim të VKM-së nr. 883, datë 14.12.2016 “Për monitorimin shkencor pasvaksinal të kafshëve të vaksinuara në kuadër të projektit “përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit ndaj sëmundjeve zooteknike (PAZZA” si dhe të Autorizimit të Ministrisë të Mjedisit nr. 8291, datë 20.12.2016 “Për marrjen e kampioneve të dhelprës së kuqe për qëllime kërkimore – shkencore”).

Po në këtë kuadër lidhur me faunën jemi bërë pjesë e takimeve dhe për “Problemet e shpëtimit të kafshëve të egra në gjendje kaptiviteti”. Morëm pjesë në këto takime dhe në Kosovë ku u zhvillua një seminar lidhur me nxjerrjen e disa arinjve nga kushtet e robërisë që ishin nëpër zona të ndryshme të vendit.

Spektori i menaxhimit ka ndjekur me vëmendje e ka dhënë ndihmesë edhe në procesin e prodhimit të tabelave që do të vendoseshin në zonat e mbrojtura. Kështu në bashkëpunim me AdZM-të dhe të specialistit të GIS-it u bë e mundur caktimi i vendit ku do të vendosej tabela (klasifikuar sipas llojit të saj) po kështu dhe me ndihmën e specialistit të dizajnit u përcaktua përshkrimi e përmbajtja e tabelave që u përgatitën dhe u vendosën në të gjithë territorin e zonave të mbrojtura, kjo sipas një përcaktimi paraprak që u bë. Tabelat janë prodhuar gjithsej 119 copë, në 6 lloje të të ndryshme.

Sektori i menaxhimit dhe ai i monitorimit kanë marrë pjesë në grupet e punës për zbatimin e Urdhërit të Ministrit të Mjedisit nr. 10, datë 20.01.2016 “Mbi procedurën e dyllosjes së zyrave të DRSHP e seksioneve pyjore në gjithë vendin”, e në përfundim të procesit të dyllosjes hartuan një raport mbi ecurinë e tij. Me Urdhërin e Ministrit të Mjedisit nr. 85, datë 18.04.2016 këto grupe pune në bashkëpunim me AdZM-të e qarqeve kanë vazhduar dhe monitoruar procesin e ndarjes së zyrave dhe asetëve të tjera të ish DSHP-ve në rrethe si dhe kanë filluar inventarin në zyrat e kadastrës. Procesi përfundoi pa probleme përvec zyrës në Krujë për të cilën u hartua një Memo drejtuar Ministrit.

Sektori i menaxhimit pasi u njoh me draft ligjin e ri për Zonat e Mbrojtura morri pjesë në dëgjesat publike që u organizuan në qarqe dhe paraqiti komentet për përmirësimin e tij.

Problematika në AdZM-të

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2016 lidhur me punën e AdZM-ve ka vërejtur se krahas plotësimit të detyrave kanë patur dhe mangësi si:

AdZM-ja Berat

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në përshkrimin e informacionit.
- Nuk është përgjigjur në kohën e duhur kërkesave të bëra nga sektori i menaxhimit veçanërisht lidhur me dhënien e mendimeve të shkresave të skanuara.
- Ka patur paqartësi në hartimin dhe përpilimin e projekteve.

AdZM-ja Fier

Është vërejtur se krahas plotësimit të detyrave ka patur dhe mangësi:

- Nuk ka plotësuar në kohë dokumentacionin teknik në zbatim të urdhërit të Ministrit të Mjedisit nr. 129, datë 23.06.2016 “Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura” dhe plotësimit të kriterëve sipas Aneksit të këtij urdhëri që duhen përmbushur nga AdZM-të dhe subjekti kërkuës.

AdZM-ja Durrës

Janë vërejtur këto mangësi:

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në përmbajtjen e raporteve, informacioneve.

- Nuk është përgjigjur në kohën e duhur kërkesave të bëra nga sektori i menaxhimit veçanërisht lidhur me dhënien e mendimeve të shkresave të skanuara.
- Ka lidhur kontrata ekzistuese, mbartur nga ish-DRSHP-të, pa marrë më parë pranë AKZM-së Urdhërin e miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm.

AdZM-ja Lezhë

Janë vërejtur këto mangësi:

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi.
- Nuk ka dërguar relacion përfundimtar lidhur me mos zbatimin e Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1583, datë 25.11.2016 “Për miratimin e projektit për rehabilitimin dhe shëndetësimin e pyjeve në ZMBM “Bjeshka e Oroshit”.

AdZM-ja Korçë

Krahas punës së mirë janë vërejtur mangësi si:

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi.

AdZM-ja Tiranë

Janë vërejtur këto mangësi:

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në informacione të cilët janë të vakta dhe me përmbajtje jo të rregullt.
- Ende nuk ka dërguar Raportin Teknik të modelit standart për kontratën e lidhur për dhënie në përdorim të sipërfaqes me kontratë qiraje në PM “Mali me Gropa – Bizë – Martanesh”
- Ka lidhur një kontratë për ushtrim kullotje për vitin 2017 pa miratuar listën e parcelave nga Drejtori i Përgjithshëm.

AdZM-ja Dibër

Është vërejtur mangësi në:

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi.

AdZM-ja Elbasan

Krahas punës së mirë janë vërejtur mangësi si:

- Nuk u është përgjigjur në kohë shkresave të skanuara apo kërkesave për dhënie mendimi.

AdZM-ja Kukës

Është vërejtur se krahas plotësimit të detyrave ka patur dhe mangësi:

- Nuk ka dërguar në afat evidencat mujore.

AdZM-ja Gjirokastrë

Është vërejtur se krahas plotësimit të detyrave ka patur dhe mangësi:

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave dhe paqartësi në informacione.
- Ende nuk ka dërguar relacionin përfundimtar lidhur me zbatimin e e Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1345, datë 12.10.2016 “Për miratimin e projektit për rehabilitimin dhe shëndetësimin e pyjeve në PK “Bredhi I Hotovës - Dangëlli”.
- Nuk ka dërguar në kohë dhënien e mendimeve me shkresat e skanuara.

AdZM-ja Vlorë

Janë vërejtur mangësi në:

- Dërgimin e evidencave mujore jo në afatin e duhur, me mangësi në plotësim të rubrikave.
- Ende nuk ka dërguar të miratuar Raportin Teknik të sipërfaqes ku do të hiqen (priten) disa pemë pyjore në PK “Butrint”, si rrjedhojë e dëmtimit të mureve apo bordureve në qytetin antik.
- Nuk dërgoi brenda vitit evidencën e kontratave të lidhur në sipërfaqet kullosore.

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2016, ka kryer e realizuar detyrat e ngarkuara dhe në saj të një bashkëpunimi me institucione të ndryshme shtetërore si:

- Me Drejtorinë e Zonave të Mbrojtura dhe Biodiversitetit ku një ndër detyrat e realizuara ka qënë dhe rishikimi i planeve të menaxhimit për parqet natyrore rajonale (PNR) dhe u finalizua me përgatitjen e një Draft – Manuali për parqet natyrore rajonale (Ulëz, Kthellë, Shkrel).
- Drejtorinë e Trajtimit të Pyjeve dhe Kullotave, lidhur me problemet kadastrale.
- ISHMP-në, lidhur me faunën e egër dhe ndjekjen e procedurave për kafshët që ishin në kushte robërie (ariu i murmë).
- AKM-në, lidhur me dhëniet e mendimeve dhe lejet mjedisore të subjekteve të HEC-ve.
- MBZHRU-në për Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, ku kemi qënë pjesëmarrës në të gjitha takimet e organizuara, kërkuar dhe arritëm që AKZM-ja të jetë pjesë e kësaj strategjie. Jemi përfshirë deri në finalizimin dhe miratimin e Draftit final, me ALUIZNI-n (kemi dhënë informacion lidhur me ndërtimet që ndodhen

në zonat e mbrojtura, duke përcaktuar qartë zonën e mbrojtur, kategorinë e saj, zonimin e brendshëm dhe bazuar në planin e menaxhimit mbi lejueshmërinë e veprimtarive në këto zona),

- MZHU-në (AKPT e AZHT) për PPV të bashkive dhe problem të tjera lidhur me territorin.
- AKB dhe Ministrinë e Kulturës (IMK dhe ASHA) lidhur me PK “Butrint” dhe vijën bregdetare.

Sektori i menaxhimit gjatë vitit 2016 gjithashtu ka ndjekur

- ❖ Ka vazhduar punën për përgatitjen e kthimin e përgjigje të shkresave ardhur në adresë të AKZM-së.
- ❖ Specialistët e sektorit janë aktivizuar në punë të përbashkëta dhe me sektorin e monitorimit (gjatë kontrolleve të ushtruara në AdZM-të e qarqeve). Në bashkëpunim me këtë sektor pothuaj në të gjitha kontrollet e kryera krahas monitorimit është bërë dhe kontrolli i zbatimit të urdhërave të dala lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.
- ❖ Sektori i menaxhimit ka ndërtuar një databasë kombëtare për vendodhjen e të gjithë HEC-eve që gjenden brenda rrjetit të zonave të mbrojtura. Në bashkëpunim me AdZM-të e qarqeve u mboodh dhe u grumbullua dokumentacioni teknik që disponojnë subjektet në terren, nga ku u bë dhe klasifikimi i tyre se në çfazë janë ato (ndërtimi apo proces prodhimi). Jemi në përditësimin e këtij databezi, pasi në terren jepen informacione të reja nga AdZM-të. Një ndër detyrat më kryesore që do të vazhdojë gjatë vitit 2017, është saktësimi dhe unifikimi i këtij databezi.
- ❖ Gjatë vitit 2016 sektori i menaxhimit u njoh dhe studioi planet e menaxhimit të parqeve kombëtare. dhe për vitin 2017 në bashkëpunim me AdZM-të do të shikojë mundësinë e rishikimit të tyre.
- ❖ Është përgatitur një tabelë përmbledhëse të identifikimit të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura.
- ❖ Sektori i menaxhimit kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të organizuara nga AKZM-ja dhe institucione të tjera.

IV . Objektivat për vitin 2017.

- Detyrat kryesore të Sektorit të Menaxhimit për vitin 2017, dalin nga programi “Mbi Strategjinë kombëtare për zonat e mbrojtura” dhe konkretisht do të jenë:
- Puna e sektorit të menaxhimit gjatë këtij viti do të mbështetet në tre shtylla kryesore:
- a. Punë e thelluar (në çdo përgjigje apo dhënie mendimi të shprehemi me frazeologji e përmbajtje të thelluar, bazuar në aktet ligjore e nënligjore).
- b. Shpejtësi në veprime
- c. Saktësi në vendime.

- 1. Organizimi i punës për hartimin, standartizimin dhe mbajtjen e të gjithë të dhënave nëpërmjet përdorimit të teknologjive të avancuara. (Rregjistri Kombëtar), për të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë që do të kryhen dhe trajtohen gjatë vitit 2017.
- 2. Hartimi i skedave biologjike, unifikimi i modelit të tyre në zonat e mbrojtura.
- 3. Monitorimi i florës dhe faunës në zonat e mbrojtura, krijimi dhe mbajtja e databasës së të dhënave të marra.
- 4. Saktësimi dhe standartizimi i kadastrës të zonave të mbrojtura (zona e mbrojtur, ekonomia pyjore/kullosore, parcelat e tyre, sipërfaqet, hartat përkatëse).
- 5. Përfundimi mbi studimin dhe saktësimin e kontratave ekzistuese nga ish-DRSHP-të, ndjekja e tyre mbi zbatimin e menaxhimit e veprimtarive të lejuara deri në likuidimet financiare totale.
- 6. Hartimi i Draft- Kontratave për veprimtari të lejuara në zonat e mbrojtura duke synuar në vjeljen e grumbullimit e prodhimeve të dyta pyjore brenda zonave të mbrojtura.
- 7. Hartimin dhe zhvillimin e planeve të mbarështrimit të pyjeve nga specialistët e AdZM-ve, ndjekja e realizimit të tyre dhe përmirësimi i metodologjisë.
- 8. Hartimin dhe zhvillimin e studimeve për mbarështrimin e kullotave (për kapacitetin mbajtës, gjendjen floristike dhe elementeve të infrastrukturës e kzistuese, rekomandime për përmirësimin e tyre) nga specialistë të AdZM-ve, ndjekja e realizimit të tyre.
- 9. Hartimi i planeve dhe gjetja e metodave për mirëmenaxhimin e zonave turistike, ngritja e grupeve të punës për informimin dhe shoqërimin e turistëve që frekuentojnë këto zona.
- 10. Vënia në efikasitet e qendrave të informacionit për vizitorët.
- 11. Studimi dhe përmirësimi i disa planeve të menaxhimit, bazuar në objektivat e reja për zonat e mbrojtura dhënë nga Strategjia Kombëtare dhe PPV-të e bashkive të miratuara.
- 12. Hartimi i planeve për ndërhyrjet e nevojshme me përmirësim të infrastrukturës në zonat e mbrojtura.
- 13. Organizimi i punës për gjetjen e burimeve të të ardhurave që do të rrjedhin nga zonat e mbrojtura për çdo AdZM, si kontrata për kullotat, bimët mjeksore, prodhime të dyta pyjore e jo pyjore, dhënie në përdorim të sipërfaqeve për ushtrim aktivitetesh etj, (sipas specifikave që ka çdo zonë e mbrojtur).

Spektori i Projekteve

Gjatë këtij viti puna kryesore dhe vëmendja është përqendruar në zbatimin dhe realizimin e Objektivave të Sektorit të Projekteve si më poshtë:

I. Koordinimi, monitorimi, dhe bashkëpunimi me projektet në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe specifisht brenda zonave të mbrojtura

1.1. Nga projekti NaturAL, Natura 2000 në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të projektit janë realizuar:

- 1.1.2. Takim me ekspertin anglez në fushën e ruajtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm, për identifikimin e tematikave të programeve trajnuese, lidhur me ngritjen e kapaciteteve të stafit të AKZM dhe AdZM-ve.
- 1.1.3. Ëorkshop për krijimin dhe ngritjen e një kursi / programi bazë për trajnimin e Rangers dhe stafit të AkZM.
- 1.1.4. Trajnim i Trajnerëve, lidhur me implementin e kursit bazë për të gjithë Rangers, të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura.
- 1.1.5. 64 trajnime me stafin e të gjithë Administratave të Zonave të Mbrojtura lidhur me tematikat e mëposhtme:
 - Njohuri bazë të koncepteve biologjike dhe metodologjia e punës në terren;
 - Monitorimi i florës dhe faunës,
 - Metodologjia për Rregjistrimin/ numërimin e shpendëve ujorë, (bird count);
 - Monitorim i lakuriqëve të natës, gjitarëve të mëdhenj, dhe të vegjël dhe herpetofaunës,
 - Metodika për vendosjen kamerave kurth dhe mënyrat e investigimit për praninë e llojeve në terren.
 - Metodika e vëzhgimit, analizës së gjitarëve të vegjël, amfibëve, dhe specieve ujore, (kryesisht peshq).
 - Monitorimi i shtigjeve, brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.
- 1.1.6. Ka përfunduar rikonstrukcioni i Qendrës së Informacionit në Rezervatin Natyror të Menaxhuar lumi Buna-Velipojë si dhe Qendra e Vizitorëve në Parkun kombëtar Shebenik-Jabllanicë.

Spektori i projekteve në kuadër të koordinimit dhe bashkëpunimit për zbatimin e këtij projekti ka përgatitur:

- Databazën e të gjitha trajnimeve të realizuara për 12 AdZM-të, gjatë vitit 2016 dhe janë identifikuar përfitimet dhe mangësitë/ vështirësitë e hasura gjatë këtyre trajnimeve.
- Redaktimin gjuhësor të informacionit të tabelave informuese për 8 Parqe Kombëtarë, 4 Rezervate Natyrorë të Menaxhuar/ Parqe Natyrorë, 1 Peizazh i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Liqenit të Pogradecit.
- Ka kordinuar takimet për 4 Grupe Teknikë të Punës në fushën e turizmit të zhvillimit të qëndrueshëm, ngritjen e një infrastrukture të qëndrueshme, përdorimin e mjeteve të komunikimit dhe forcimin e kapaciteteve.
- Është organizuar takimi me grupin teknik për promovimin e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm
- Kontribut në organizimin dhe vlerësimin e konkursit të ideve Mendo NaturAL.

Për rritjen e bashkëpunimit dhe promovimin e vlerave të zonave të mbrojtura janë organizuar:

- Takim koordinues mbi komunikimin, mënyrat e zhvillimit të saj, përmes përcaktimit të logove, strategjisë së komunikimit të AKZM dhe promovimit të punës së Agjencisë, përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit.

Problematika: Pavarësisht përgatitjes dhe dërgimit të një formati standart raportimi për aktivitetet e realizuara si dhe kërkesës për marrje informacioni nga AdZM-të, nuk kemi marrë feedback, ose në rastet e pakta që ky informacion është dërguar, ky informacion ka qenë i vakët.

1.2. Në kuadër të projektit “Drejt një qeverisje më të mirë të trashëgimisë së përbashkët ndërkufitare natyrore dhe kulturore të Rajonit të Liqenit të Ohrit”,

- Janë realizuar 5 ëorkshop-e dhe 7 takime të Grupit Teknik të Punës me fokus përgatitjen e suplementit të Planit të Menaxhimit të peizazhit të Mbrojtur Tokësor - Ujor të Liqenit të Pogradecit, për përfshirjen e pjesës shqiptare të liqenit të Ohrit si pasuri e trashëgimisë botërore (UNESCO).
- 4 trajnime për ngritjen e kapaciteteve për përgatitjen e suplementit të Planit të Menaxhimit të peizazhit të Mbrojtur Tokësor - Ujor të Liqenit të Pogradecit.

Spektori i projekteve ka dhënë kontribut në:

- Përgatitjen dhe paraqitjen e komenteve dhe sugjerimeve të draft suplementit të Planit të menaxhimit të PM Tokësor-Ujor të liqenit të Pogradecit.
- Prezantim i punës së AKZM dhe roli i AdZM Korçë, gjatë trajnimit të organizuar në kuadër të planit të aktiviteteve të projektit.
- Promovimin e vlerave natyrore dhe mundësitë për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm me bazë natyrën, në liqenin e Ohrit, nëpërmjet intervistës për faqen ndërkombëtare ëëë.pedalingpictures.us.

Për projektet e mëposhtme:

1.3. CABRA 2 “Ruajtja dhe Përdorimi i Biodiversitetit në zonat rurale në Shqipëri” :

- Është mbajtur prezantim për rritjen e bashkëpunimit dhe prezantimin e punës së AKZM, gjatë zhvillimit të takimit për prezantimin e aktorëve, në kuadër të zbatimit të projektit.
- Është realizuar një takim për ngritjen e grupit të punës për shpalljen e masivit të gështenjës së Tropojës, zonë e mbrojtur. Procesi ka ngelur në mes, deri në sqarimin e mëtejshëm të problematikës së pronësisë nga ana e pushtetit lokal.

Problematika: Informacion tjetër, për aktivitetet që organizohen (përveç ftesave që vijnë për pjesëmarrje), apo dokumenta të tjera të projektit, si plan pune, mungojnë, për të njëjtat arsye të sipërpërmendura dhe për projektet e tjera.

1.4. CSBL “Ruajtja dhe përdorimi qëdrueshëm i biodiversitetit në Liqenin e Shkodrës Prespës dhe Ohrit faza II.

- Është marrë pjesë në takimin rajonal të aktorëve kryesorë, për implementin e Direktivës Kuadër të Ujit.

Problematika: Lidhur me aktivitetet e tjera të organizuara në kuadër të këtij projekti nuk na vjen asnjë informacion, pavarësisht kërkesës me mjete të ndryshme komunikimi (email, telefon, takim etj.). Nuk është e mundur ngritja e një bashkëpunimi efektiv me stafin e projektit.

1.5. Projekti Monitorimi i Inventarizimit të Faunës së Egër - INCA.

Spektori i Projekteve ka qenë pjesë e trajnimit të mbajtur në AKZM, lidhur me mënyrën e plotësimit të skedarëve të monitorimit dhe hedhja e tyre në sistem, nga stafi në terren i Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura.

Problematika: Informacion apo dokumenta të tjerë të projektit nuk disponojmë. Mungesë e koordinimit të punës, midis sektorit të projekteve dhe sektorit të menaxhimit për përcjelljen e informacionit të kërkuar.

1.6. Projekti “Ndërtimi për Rikuperimin e Lagunës të Kune-Vainit nëpërmjet Përshtatjes të Bazuar në Ekosistem (EbA)” janë mbajtur:

- 1 takim me stafin e projektit në kuadër të ngritjes së bashkëpunimit për realizimin me sukses të projektit,
- 1 takim me komitetin drejtues për paraqitjen e draft planit të aktiviteteve dhe buxhetit, si dhe
- takimi lancues për fillimin e projektit.

Problematika. Informacion për ecurinë e mëtejshme të projektit nuk kemi marrë. Arsyet për mungesën e informacionit janë të njëjta si dhe për projektet e tjera të sipërpërmendura.

II. Rritja e vlerave turistike të Zonave të Mbrojtura nëpërmjet ruajtjes, promovimit të vlerave për këto zona.

- 2.1. Është organizuar Forumi Koordinues i Donatorëve me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve kryesorë, që punojnë në fushën e mbrojtjes së natyrës.
- 2.2. Është organizuar Konferenca për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në kuadër të javës së turizmit, me qëllim forcimin e bashkëpunimit me operatorët, bizneset/ individët privatë për aktivitetet në fushën e turizmit brenda zonave të mbrojtura.
- 2.3. Janë përgatitur dhe dërguar dokumentat e aplikimit për anëtarësimin e AKZM si pjesë e rrjetit të MedPAN dhe IUCN. Kjo e fundit është ende në proces shqyrtimi.
- 2.4. Janë përgatitur dhe dërguar dokumentat për 6 aplikime në kuadër të thirrjes së parë të programit ADRION, 1 prej të cilave, është vlerësuar pozitivisht për kalimin e fazës së parë.
- 2.5. Është përgatitur një koncept ide për ngritjen e kapaciteteve të stafit të AKZM dhe AdZM-ve, në kuadër të programit IPA 2016, e cila i është dërguar Ministrisë së Mjedisit (Sektorit të Biodiversitetit), sipas kërkesës.

Problematika në tërësi:

- Kërkesa për bashkëpunim me administratat, për dërgimin e nevojave apo prioriteteve më imediate dhe përpunimin e tyre në një koncept ide, nuk ka funksionuar. Shumë shpesh kapërcehen dhe anashkalohen hallkat për dërgimin e informacionit.
- Është përgatitur dhe dërguar një format standart për t'u plotësuar me informacionin e kërkuar, (lidhur me aktivitetet që janë realizuar në kuadër të projekteve), por nuk ka funksionuar.
- Në fillim ka pasur një plotësim të pjesshëm të tij, (pas disa komunikimeve dhe kujtesave) nga disa prej administratave, por që ka ardhur në rënie deri në mosmarrjen më të një feedback-u për plotësimin e tij.
- Gjithashtu kemi vështirësi në marrjen e informacionit për ecurinë e projekteve, nga stafi që zbaton projektet. Në shumicën e rasteve ky informacion nuk vjen ose vjen në formën e një fletëvolanti, apo fletëpalosje.

III. Koordinimi, raportimi dhe identifikimi i problemeve, lidhur me progresin e punës për Strukturat e BE-së, përgatitja e kontributit për PKIE dhe planin e 600 ditëshit.

- 3.1. Janë përgatitur për 3 mujorin e parë të vitit raportet javorë dhe periudhën tjetër raportet mujorë të aktiviteteve të ndërmarra nga AKZM dhe AdZM-të në përmbushje të detyrës, referuar Axhendës së Integrimi.
- 3.2. Është përgatitur dhe dërguar raporti javor mbi Programin e Buxhetimit Afatmesëm (600 ditëshi), për 6 mujorin e parë të vitit 2016.

- 3.3. Janë përgatitur 4 (katër) raport progrese për kapitullin e 27 të Mjedisit, në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga pala Europiane, si dhe realizimin e masave të parashikuara në PKIE 2015 – 2020.
- 3.4. Është përgatitur Urdhri i brendshëm lidhur me procedurat për lëvizjet brenda dhe jashtë vendit, të stafit të AKZM, dhe AdZM-ve
- 3.5. Është përgatitur në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme, programi i buxhetimit afatmesëm për periudhën 2016-2018.

IV. Futja e elementëve të rinj që lidhen me komunikimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin për të ndryshuar perceptimin dhe rolin e këtyre zonave për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm

- 4.1. Është përgatitur dhe dërguar shkresa zyrtare për bashkëpunim me OJF-të mjedisore.
- 4.2. Është përgatitur draft programi i punës për studentët e praktikës, pjesë e shtyllës së tretë të Strategjisë së AKZM.
- 4.3. Është përgatitur draft Marrëveshja e Bashkëpunimit me Universitetet kryesore të vendit, për realizimin e praktikave tremujore të studentëve, pranë AKZM.
- 4.4. Është ngritur bashkëpunimi dhe janë vendosur kontaktet midis AKZM/ AdZM-ve dhe OJF-ve, që promovojnë zonat e mbrojtura nëpërmjet aktiviteteve të tyre.
- 4.5. Në kuadër të promovimit të vlerave natyrore, kulturore të zonave të mbrojtura si dhe të menaxhimit dhe ruajtjes së tyre në Shqipëri, është mbyllur me sukses Panairi “Terra Madre Balkans”.
- 4.6. Është ngritur bashkëpunimi ndërmjet AKZM dhe Agjencisë Çeke për Ruajtjen e Natyrës.
 - Janë përgatitur draft marrëveshja e bashkëpunimit dhe plan veprimit midis dy Agjencive.
 - Është organizuar vizita studimore si hap i parë i zbatimit të kësaj marrëveshje.
- 4.7. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis AKZM dhe Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, është prezantuar roli i AKZM në zbatimin e kësaj marrëveshje, në emisionin “Ëake Up”.
- 4.8. Redaktim gjuhësor i materialeve që do të përdoren në ngritjen e infrastrukturës së rrjetit të zonave të mbrojtura.

V. Ngritja e kapaciteteve të stafit dhe komunikimi

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara, nga projekte apo institucioneve të ndryshme, stafi i projekteve ka marrë pjesë në:

- 5.1. 3 Konferenca rajonale të projektit Brezi i Gjelbër i Ballkanit (Balkan Green Belt),
- 5.2. Trajnimin “Ngritja dhe përdorimi i sistemeve të monitorimit” në kuadër të Projektit të Bankës Botërore për Shërbimet Mjedisore.
- 5.3. Konferencën “Për ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri”, Romë, organizuar në kuadër të projektit IUCN.
- 5.4. Pjesëmarrje dhe prezantim në takimin e aktorëve dhe palëve të interesuara, në kuadër të projektit CABRA II “Biodiversiteti në Shqipëri-Mundësi për njerëzit dhe natyrën”
- 5.5. Pjesëmarrje në takimet e grupit ndërinstitucional të punës , në kuadër të Planit Kombëtar të Adaptimit për Ndryshimet Klimatike.
- 5.6. Seminarin për manaxhimin e suksesshëm të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar INTERREG-IPA, organizuar nga INTERACT me financim të ERDF.
- 5.7. Takimin e organizuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit, në kuadër të projektit “Përgatitja e Programit Strategjik të vendit (CPS), për Fazën Operacionale 6 të GEF 2014-2018”.
- 5.8. Takimin e organizuar nga Ministria e Mjedisit, në kuadër të projektit të shërbimeve mjedisore, financuar nga Banka Botërore.
- 5.9. Takimin e organizuar nga Ministria e Mjedisit, në kuadër të lancimit të projektit “Për ngritjen e Sistemit të Monitorimit Mjedisor” financuar nga UNDP, si pjesë e grupit të punës në këtë projekt.

VI. Detyra të tjera

Në përputhje me veprimtarinë e Agjencisë, stafi i sektorit të projekteve është angazhuar në përmbushjen e detyrave të tjera:

- 6.1. Pjesëmarrje në grupin e punës për inspektimin në Parkun Kombëtar të Prespës dhe në Ersekë.
- 6.2. Hedhja e të dhënave në excel të komisioneve të ngritura për miratimin ose jo të aktiviteteve që do të zbatohen dhe zhvillohen në zona specifike.

- 6.3. Pjesë e komisionit për realizimin e procesit të inventarizimit dhe marrjes në dorëzim të dokumentave të projektit “ Rezervati biosferik ndërkufitar i Prespës-Mbështetje për Parkun Kombëtar të Prespës në Shqipëri-faza I.
- 6.4. Pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për identifikimin e nevojave për rehabilitimin e shtretërve të lumenjve.
- 6.5. Është përgatitur raporti përmbledhës me komentet e përfaqësuesve të AdZM-ve si pjesë e Grupit të punës, për rehabilitimin e shtretërve të lumenjve.
- 6.6. Kontribut në përgatitjen e raportit të Planit Kombëtar të Përshtatjes si dhe përcaktimin e veprimeve prioritare në fushën e mbrojtjes së natyrës.

VII. Mangësi dhe problematika të hasura gjatë vitit 2016

- 7.1. Rritje e kapaciteteve të stafit me pjesëmarrjen në trajnime me fokus në fushën e konceptimit, hartimit dhe menaxhimit të projekteve;
- 7.2. Koordinim më i mirë dhe përcjellje informacioni ndërmjet sektorëve dhe AdZM-ve;
- 7.3. Forcim i bashkëpunimit ndërmjet projekteve që zbatohen në zonat e mbrojtura, përsa i përket aspektit praktik si dhe dokumentacionit bazë të projekteve. (plan pune, plan aktivitetesh, etj.)

Spektori i Monitorimit

Gjatë këtij viti puna kryesore dhe vëmendja e sektorit të monitorimit është përqendruar në zbatimin dhe realizimin e monitorimit të gjendjes së biodiversitetit, habitateve, popullatave të specieve të florës dhe të faunës së egër dhe ekosistemeve natyrore, që mund të jenë ose rrezikohen të dëmtohen nga veprimtari e ndryshme në zonat e mbrojtura.

Janë kryer kontrole të vazhdueshme duke monitoruar realizimin e detyrave të AdZM-ve në qarqe, problematikat e ngritura nga këto administrata si dhe ato të dala në terren.

Nga Spektori i Monitorimit në cdo fund muaji dhe në mënyrë progresive ka marrë informacion nga çdo AdZM me anë të plotësimit të setit të evidencave.

Në mbështetje të të gjithave të dhënave të ardhura nga AdZM-të e qarqeve, në bazë të plotësimit të dokumentacionit të dërguar nga Spektori i Monitorimit në AKZM, është krijuar database kryesor për të gjitha AdZM-të e qarqeve, ku janë të regjistruara të gjitha proces verbalët e konstatimit të dëmeve, të zjarreve në zonat e mbrojtura si dhe problematikat e tjera të konstatuara nga Spektoret e Monitorimit në AdZM-të e qarqeve.

Kjo praktikë pune është ndjekur nga Sektori i Monitorimit në AKZM për çdo fund muaji, ku është bërë evidentimi i të gjitha problematikave për të ardhmen, dhe është punuar për zgjidhjen e tyre.

Të gjitha proces-verbale të konstatimit të dëmit në zonat e mbrojtura, të mbajtura nga Rojet Mjedisore në AdZM-të e qarqeve ku një kopje është dorëzuar pranë ISHMP-së Rajonale, një kopje e ardhur pranë Sektorit të Monitorimit në AKZM-në, me shkresë zyrtare është dërguar për çdo muaj pranë ISHMP-së Qendror për ndjekjen e procedurave të tjera ligjore, kompetencë e të cilave është ISHMP-ja.

Në kuadër të bashkëpunimit të punës mes AKZM-së dhe ISHMP-së në mënyrë sa më korrekte, në përmbushje të detyrave në lidhje me mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, si dhe evidentimit dhe ndëshkimit të aktiviteteve të paligjshme në pyje në ZM, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Sektori i Monitorimit duke filluar nga muaji Mars-Dhjetor 2015 dhe gjatë gjithë vitit 2016, ka dërgur kopje të të gjitha proces-verbaleve të konstatimit të dëmvë në ZM mbajtura nga ana e AdZM-ve në qarqe pranë institucionit qendror të ISHMP-së

Problematikë:

Për këtë deri tani nuk kemi asnjë informacion mbi ecurinë e procedurave të ndjekura nga ana e ISHMP-së në lidhje me këto proces-verbale, gjë e cila do të na mundësonte ndjekjen e mëtejshme të procedurave nga ana e AKZM-së, këtu mund të veçojmë 5 raste të ardhura nga ISHMP-ja e Qarkut Elbasan dhe 2 raste ISHMP-ja Durrës ku praktikat e ardhura kanë përfunduar proceset gjyqësore mbi vjeljen e gjobës nga ISHMP-ja dhe më pas AKZM-ja duhet të kishte ndjekur procedurat për vjeljen e vlerës së dëmit, gjë e cila deri tani nuk është kryer në asnjë rast.

Në kuadër të parandalimit të rënies së zjarreve në zonat e mbrojtura, Sektori i Monitorimit në AKZM ka kërkuar nga të gjithë AdZM-të e qarqeve që në bashkëpunimin me pushtetin vendor dhe me institucionet e tjera, marrjen e masave mbrojtëse për parandalimin e tyre në pyje dhe kullota. Për këtë në fillim të vitit është hartuar plani operacional i masave për vitin 2016 që duhet marrë për parandalimin e mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave në Zonat e Mbrojtura nga zjarri dhe pasi është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura z. Zamir Dedej, është shpërndarë institucioneve të varësisë në Qarqe që janë Administratat e Zonave të Mbrojtura (AdZM) për zbatim, plan në të cilin janë përcaktuar masat që do të merren në zbatim të objektivit dhe konkretisht:

- Pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura është ngritur Shtabi Qendror i MNZSH-së i përbërë nga përfaqësues të administratës qendrore, i cili bën vlerësimin konkret të situatave të krijuara, merr vendime dhe masa suplementare që kanë si objekt përmirësimin e punës, ushtron kontrole në AdZM-të në Qarqe për zbatimin e masave për mbrojtjen nga zjarri, harton dhe shpërndan komunikata periodike për shtyp.
- Në çdo Administratë e Zonave të Mbrojtura (AdZM) në Qarqe, janë ngritur e funksionojnë shtabet lokale të MNZSH-së, të cilat hartojnë planin e veprimit në nivel rajonal dhe lokal, në bashkëpunim e bashkëveprim me organet e qeverisjes vendore dhe ato të specializuara, si Prefekturat (Zyrat e Emergjencave Civile), Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (PMNZSH), degët rajonale të ISHMP, subjektet juridike e fizike, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë aktivitete në fondin pyjor dhe kulllosor.
- Në zbatim të VKM-së Nr.1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësisve vullnetare të shuarjes së zjarreve” dhe për Udhëzimin e Përbashkët me Ministrinë e Brendshme (Pushtetin Vendor), në bazë fshati, janë organizuar skuadrat vullnetare të gadishmërisë për MNZSH-në me elementë të përkushtuar të komunitetit, në krye të të cilave janë kryetarët e fshatrave dhe inspektorë rojet mjedisore (Rangersat), ku janë mbajtur proces-verbale me emrat e vullnetarëve, numrat e kontaktit si dhe të firmosura e vulosura nga kryetarët e fshatrave dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura.
- Përdorimi efektiv i burimeve njerëzore, materiale dhe financiare dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, ku çdo Administratë e Zonave të Mbrojtura (AdZM) në Qarqe ka vënë në gadishmëri të plotë të gjithë bazën materiale ekzistuese (veglat e punës, fikset, mjetet lëvizëse etj.) për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe sistemin e vrojtimit-sinjalizimit.

Zbatimi i këtij plan-masash nga Administratat e Zonave të Mbrojtura (AdZM) në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përmendura më lart, ka dhënë rezultatet e pritshme në ato zona që kemi pasur raste të rënies së zjarreve brenda Zonave të Mbrojtura, duke minimizuar dëmet me anë të izolimit e deri në fikjen e zjarreve.

Gjatë gjithë periudhës së vitit 2016 në Sektorin e Monitorimit pranë AKZM-së janë regjistruar **216** Proces-verbale të konstatimit të dëmit në zonat e mbrojtura të ndarë sipas qarqeve:

1. Qarku Tiranë

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar - Dhjetor janë mbajtur **28 raste** dëmtimesh, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të demit, *24 raste pa autor dhe 4 raste me autor.*

- a. 19 raste në PK “Mali i Dajtit” ku janë prerë 603 copë pemë të llojeve Ah, Mare, Shqipë, Shkozë e Lis
- b. 9 raste në PM “Mali me Gropa Bizë Martanesh” ku janë prerë 826 opë pemë të llojit Ah.

➤ **Mbrojtja nga Zjarret:**

Për periudhën Janar- Dhjetor ka patur *5 raste* të rënies së zjarrit, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të demit pa autor.

- a. 3 raste në PK “Mali i Dajtit” ku kemi patur përkrah të sipërfaqes së zjarrit prej 50.7 Ha në PK Mali i Dajtit në ekonominë pyjore “Shkallë”
- b. 2 raste në në PM “Mali me Gropa Bizë Martanesh” ku kemi patur përkrah të sipërfaqes së zjarrit 12 Ha në ekonominë pyjore “Bizë, Linos Rinas”.

Në total nga AdZM-ja e qarkut Tiranë janë mbajtur 33 proces-verbale konstatimi nga këto 29 raste pa autor dëmi dhe 4 raste me autor dëmi ose 12% e rasteve me autor dëmi

2. Qarku Berat

Për periudhën Janar-Dhjetor 2016 janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **5 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të demit pa autor

- a. 5 raste në PK “Mali i Tomorrit” ku janë prerë 48 pemë të llojeve Pishë, Ah, Rrobull në ekonominë pyjore “Tërvi Tërrovec, Hija e Roshnikut, Mali i Tomorrit”.

➤ **Mbrojtja nga Zjarret:**

Për periudhën Janar- Dhjetor ka patur *2 raste* të rënies së zjarrit sporadike sipas informacioneve mujore por nga AdZM-ja Berat *nuk janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të demit të rasteve të rënies së zjarrit*

➤ **Sëmundjet dhe dëmtuesit:**

Për periudhën Janar - Dhjetor janë konstatuar 3 raste, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të demit nga shkaqet natyrore.

- b. në PK “Mali i Tomorrit” ku janë prekur nga sëmundja Procesionarja e Pishës një Sipërfaqe prej 704 Ha.

Në total nga AdZM-ja e qarkut Berat janë mbajtur 7 proces-verbale konstatimi nga këto 7 raste pa autor dëmi dhe 0 raste me autor dëmi ose 0% e rasteve me autor dëmi.

3. Qarku Dibër

Për periudhën Janar- Dhjetor 2016 janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **6 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit pa autor dëmi.

- a. 2 raste në PM “Mali me Gropa Bizë Martanesh” ku janë prerë 75 pemë të llojit Ah në ekonominë pyjore Ballenjë, Linos Guri i Bardhë.
- b. 2 raste në BM “Luzni Bulac” ku janë prerë 37 pemë të llojit Ah në ekonominë pyjore “Muhërr Sinë”.
- c. 2 raste në PN “Korab Koritnik” ku janë prerë 244 pemë të llojit Bredh në ekonominë pyjore “Sillovë”.

➤ **Mbrojtja nga Zjarret:**

Për periudhën Janar- Dhjetor ka patur 2 raste të rënies së zjarrit, ku është mbajtur proces verbali i konstatimit të dëmit pa autor.

- a. 1 rast në ZM BM “Luzni Bulac” ku kemi patur përshkrim të sipërfaqes së zjarrit prej 33.5 Ha në ekonominë pyjore “Muhërr Sinë”.
- b. 1 rast në PN “Korab Koritnik” ku kemi patur përshkrim të sipërfaqes së zjarrit

➤ **Ndotja e Mjedisit:**

Për periudhën Janar- Dhjetor sipas informacionit të ardhur është konstatuar një rast i hedhjeve të mbeturinave urbane në PM “Mali me Gropa Bizë Martanesh”, për këtë rast *nuk është mbajtur proces verbali i konstatimit të dëmit.*

Në total nga AdZM-ja e qarkut Dibër janë mbajtur 8 proces-verbale konstatimi nga këto 8 raste pa autor dëmi dhe 0 raste me autor dëmi ose 0% e rasteve me autor dëmi.

4. Qarku Durrës

Për periudhën Janar-Dhjetor 2016 janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **5 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku 2 raste me autor dhe 3 raste pa autor.

- a. 1 rast në PK “Qafë Shtamë” ku janë prerë 34 pemë të llojit Shkozë në ekonominë pyjore “Qaf Shtamë, Shkretë”.
- b. 2 raste në PK “Mali i Dajtit” ku janë prerë 104 pemë të llojit Lis në ekonominë pyjore “Bruz Rrazë”,
- c. 1 rast në RNM “Rrushkull” ku janë prerë 4 pemë të llojit Lis në ekonominë pyjore “Rrushkull”.

- d. 1 rast në MN “Gryka e Vajës” përvetësim dru zjarri me ngarkesë kali në ekonominë pyjore “Krastë Krujë”.

➤ **Monitorimi i ndërhyrjeve dhe dëmtimeve në zona të mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **11 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku 3 raste me autor dhe 8 raste pa autor.

- a. 7 raste në PK “Qaf- Shtamë” germim të fondit pyjor me sipërfaqe 600 m² dhe shpyllëzim të fondit pyjor me sipërfaqe 0.03 Ha në ekonominë pyjore “Qaf- Shtamë, Shkretë”.
- b. 1 rast në PK “Mali i Dajtit” germim të fondit pyjor me sipërfaqe 105 m² në ekonominë pyjore “Bruz Rrazë”.
- c. 1 rast në RNM “Rrushkull” germim të fondit pyjor me sipërfaqe 4.5 m² në ekonominë pyjore “Rrushkull”.
- d. 1 rast në MN “Plazhi i Shënpjetrit” ku kemi ndërtim grardhi 450 ml në ekonominë pyjore “Rrotull”.

➤ **Zënie të fondit pyjor:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **2 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit me autor.

- a. 1 rast në RNM “Rrushkull”, ku kemi zënie të fondit pyjor në një sipërfaqe prej 64 m² në ekonominë pyjore “Rrushkull”.
- b. 1 rast në MN “Plazhi i Shënpjetrit” ku kemi përdorim të fondit pyjor pa leje me një sipërfaqe prej 900 m² në ekonominë pyjore “Rrotull”.

Në total nga AdZM-ja e qarkut Durrës janë mbajtur 13 proces-verbale konstatimi nga këto 6 raste pa autor dëmi dhe 7 raste me autor dëmi ose 54 % e rasteve me autor dëmi

5. Qarku Elbasan

Për periudhën Janar- Dhjetor 2016 janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **14 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit ku 10 raste pa autor dhe 4 raste me autor.

- a. 13 raste në PK “Shebenik – Jabllanicë” ku janë prerë 121 pemë të llojit Ah në ekonominë pyjore “Rrajcë”.
- b. 1 rast në MN “Druri i Bizhgës” ku është prerë 1 pemë e llojit Ah që ishte monument natyre në ekonominë pyjore “Sopot”. (mungon një raport ku të jepen arsyet e prerjes së kësaj peme Monument Natyre)

➤ **Monitorimi i ndërhyrjeve dhe dëmtimeve në zona të mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor është konstatuar **1 rast** nga shkaqet natyrore (Shirat e rrëmbyer) në MN “Pylli aluvional i Shushicës” ku janë gërryer një sipërfaqe prej 0.3 Ha në ekonominë pyjore “Polis Vosjan”, për këtë rast është mbajtur proces verbal i konstatimit të dëmit.

➤ **Zënie të fondit pyjor:**

Për periudhën Janar - Dhjetor janë konstatuar **2 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit me autor

- a. 2 raste në MN “Mali i Gradishtës” ku kemi zënie të fondit kullësor në një sipërfaqe prej 0.65 Ha.

➤ **Sëmundjet dhe dëmtuesit:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar 2 raste ku nga shkaqet natyrore janë prekur nga sëmundja Procesionarja e Pishës një Sipërfaqe prej 246.6 Ha, për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit.

- a. 1 rast në PK “Mali i Tomorrit”.
- b. 1 rast në MN “Pisha e Fushkuqes”

Në total nga AdZM-ja e qarkut Elbasan janë mbajtur 16 proces-verbale konstatimi nga këto 10 raste pa autor dëmi dhe 6 raste me autor dëmi ose 38 % e rasteve me autor dëmi

6. Qarku Fier

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **6 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku 3 raste pa autor dhe 3 raste me autor.

- a. 3 raste në PK “Divjakë Kasravasta” ku janë prerë 35 pemë të llojit Pishë e Frashër në ekonominë pyjore “Pisha e Divjakës”.
- b. 1 rast në MN “Rrepet e Poçenit” ku është prerë 1 pemë e llojit Plep ekonominë pyjore “Poçen”.
- c. 2 rast në RNM “Pishë Poro” ku janë prerë 12 pemë të llojit Pishë e Ekualipt në ekonominë pyjore “Bregdet - Pishë Poro”.

➤ **Monitorimi i ndërhyrjeve të dëmtimeve në zona të mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar 2 raste, për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit pa autor.

- a. 2 raste në PK “Divjakë Kasravasta” ku janë sekuestruar 180 copë bimë narkotike si dhe një mjet gjërmues në ekonominë pyjore “Pisha e Divjakës”.

➤ **Monitorimi i gjuetisë**

Gjatë kontrolleve të ushtruara në periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **4 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit me autor të gjuetisë së paligjshme.

- a. 2 raste në PK “Divjakë Karavasta” ku gjuetarëve iu është sekuestruar arma e gjahut.
- b. 2 raste në RNM “Pishë Poro” ku gjuetarëve iu është sekuestruar arma e gjahut.

➤ **Zënie të fondit pyjor:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **2 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit me autor.

- a. 2 raste në PK “Divjakë Karavasta” ku janë zënë një sipërfaqe prej 3800 m2.

➤ **Ndotja e Mjedisit:**

Për periudhën Janar- Dhjetor është konstatuar 1, ku për këtë rast është mbajtur proces verbali i konstatimit të demit me autor.

- a. 1 rast në PK “Divjakë Karavasta” ku nga Bashkia Divjakë është bërë djegia e mbetjeve urbane në ekonominë pyjore “Pisha e Divjakës”.

Në total nga AdZM-ja e qarkut Fier janë mbajtur 13 proces-verbale konstatimi nga këto 5 raste pa autor dëmi dhe 8 raste me autor dëmi ose 62 % e rasteve me autor dëmi

7. Qarku Gjirokastrë

Për periudhën Janar- Dhjetor 2016 janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **5 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të demit pa autor.

- a. 5 raste në PK “Bredhi i Hotovës-Dangëll” ku janë prerë 72 pemë të llojit Pishë e Frashër në ekonominë pyjore “Petran Çarshovë, Lomnicë”.

➤ **Zënie të fondit pyjor:**

Për periudhën Janar- Dhjetor është konstatuar **1 rast**, ku për këtë rast është mbajtur proces verbalet e konstatimit të demit me autor.

- a. 1 rast në PK “Bredhi i Hotovës-Dangëll” ku është zënë të një sipërfaqe për ndërtimin e një godine druri pa leje.

➤ **Mbrojtja nga Zjarret:**

Për periudhën Janar- Dhjetor ka patur **2 raste** të rënies së zjarrit ku është mbajtur proces verbali i konstatimit të demit pa autor.

- a. 2 rast në PK “Bredhi i Hotovës-Dangëll” ku kemi patur përshkrim të sipërfaqes së zjarrit prej 6.55 Ha në ekonominë pyjore “Dangëlli, Petran Zavalan”.

Në total nga AdZM-ja e qarkut Gjirokastrë janë mbajtur 8 proces-verbale konstatimi nga këto 7 raste pa autor dëmi dhe 1 rast me autor dëmi ose 13 % e rasteve me autor dëmi

8. Qarku Korçë

Për periudhën Janar- Dhjetor 2016 janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **30 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të demit, ku 4 raste pa autor dhe 26 raste me autor.

- a. 14 raste në PK “Prespë” ku janë prerë 60 pemë dhe sekuestruar 4 copë ngarkesa kali me dru zjarri të llojeve Dushk e Shkozë në ekonominë pyjore “Liqenas, Qafa Xvezdës Trestenik”.
- b. 7 raste në PM “Liqeni i Pogradecit” ku janë prerë 72 pemë e llojit Gështënjë në ekonominë pyjore “Gështënja e Pogradecit, Alarup”.
- c. 1 rast në RNM “Cangoj” ku janë prerë 30 pemë të llojit Akacie, Lajthi e Dushqe në ekonominë pyjore “Zambak Vërlon”.
- d. 6 raste në PK “Bredhi i Drenovës” ku janë prerë 28 pemë të llojeve Bredh e Pishë në ekonominë pyjore “Bazdovec”.
- e. 2 raste në MN “Pylli i Fazanit” ku janë prerë 16 pemë të llojit Plep.

➤ **Monitorimi i ndërhyrjeve dhe dëmtimeve në zona të mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **2 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku 1 rast pa autor dhe 1 rast me autor.

- a. 2 raste në PM “Liqeni i Pogradecit” ku kemi ndërtim kamine dhe hapje rruge në fondin e zonës së mbrojtur në ekonominë pyjore “Gështënja e Pogradecit”.

➤ **Mbrojtja nga Zjarret:**

Për periudhën Janar- Dhjetor ka patur **5 raste** të rënies së zjarrit ku për këto e janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit pa autor.

- a. 2 rast në PK “Prespë” ku kemi patur përshkrim të sipërfaqes së zjarrit prej 0.03 Ha në ekonominë pyjore “Qafa Xvezdës Trestenik”.
- b. 2 rast në PM “Liqeni i Pogradecit” ku kemi patur përshkrim të sipërfaqes së zjarrit prej 15 Ha në ekonominë pyjore “Alarup”.
- c. 1 rast në ZMBM “Guri i Nikës” ku kemi patur përshkrim të sipërfaqes së zjarrit me djegie ku sipërfaqe e përshkruar është 3.36 Ha dhe e djegur 0.84 Ha.

Në total nga AdZM-ja e qarkut Korçë janë mbajtur 37 proces-verbale konstatimi nga këto 10 raste pa autor dëmi dhe 27 raste me autor dëmi ose 73 % e rasteve me autor dëmi

9. Qarku Shkodër

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **5 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku 4 raste pa autor dhe 1 raste me autor.

- a. 3 raste në RNM “Liqeni i Shkodrës” ku janë prerë 33 copë pemë të llojeve Shelg e Plep.
- b. 2 rast në PMUT “Lumi Buna Velipojë” ku janë prerë 8 copë pemë të llojit Pishë.

➤ **Monitorimi i ndërhyrjeve të dëmtimeve në zona të mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **5 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku 1 raste pa autor dhe 4 raste me autor.

- a. 4 raste në RNM “Liqeni i Shkodrës” ku kemi shpyllëzim të fondit pyjor në një sipërfaqe prej 0.45 Ha dhe Gërmin të fondit pyjor në një sipërfaqe prej 7240 m²

- b. 1 rast në PMUT “Lumi Buna Velipojë” i dëmtimit të zonës së mbrojtur nga shkaqet natyrore (shirat dhe erërat e forta) në vendin e quajtur Rezervat Velipojë, rruga auto Pulaj- bregu i Lumit Buna rezulton se janë dëmtuar (rrëzuar) 19 copë pemë të llojit Vërrë.

➤ **Monitorimi i Gjuetisë:**

Gjatë kontrolleve të ushtruara në periudhës Janar- Dhjetor janë konstatuar **12 raste** të gjuetisë së paligjshme (Peshkim), ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku 9 raste pa autor dhe 3 raste me autor.

- a. 6 raste në RNM “Liqeni i Shkodrës” ku janë sekuestruar 3 copë gjeneratorë dhe 550 ml rretë peshkimi.
- b. 6 raste në PMUT “Lumi Buna Velipojë”, ku kemi çmontimin e 6 copë ujshqejza dhe 2 copë ndërtin strukture për peshkim të paligjshme.

➤ **Mbrojtja nga Zjarret:**

Për periudhën Janar- Dhjetor ka patur **2 raste** të rënies së zjarrit, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit pa autor.

- a. 1 rast në RNM “Liqeni i Shkodrës” ku kemi patur përshkrim të sipërfaqes nga zjarri prej 0.2 Ha.
- b. 1 raste në PMUT “Lumi Buna Velipojë”, ku kemi patur përshkrime djegie të sipërfaqes nga zjarri prej 37.1 Ha.

Në total nga AdZM-ja e qarkut Shkodër janë mbajtur 24 proces-verbale konstatimi nga këto 16 raste pa autor dëmi dhe 8 raste me autor dëmi ose 33 % e rasteve me autor dëmi

10. Qarku Lezhë

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **6 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku të 6 rastet janë pa autor.

- c. 4 raste në RNM “Kune Vain Tale” ku janë prerë 60 copë pemë të llojeve Marinë, Pishë, Vërrë.
- d. 2 raste në RNM “Berzane” ku janë prerë 36 copë pemë të llojit Lis dhe Rrap.

➤ **Kullotje pa leje**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **1 rast**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, me autor demi

- a. 1 rast në RNM “Kune Vain Tale” nga kullotje pa leje në fondin kullor.

➤ **Monitorimi i ndërhyrjeve dhe dëmtimeve në zona të mbrojtura:**

- a. Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar 6 raste, ku për këtë rast janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku 3 raste nga shkaqet natyrore dhe 3 raste me autor, 1 rast pa autor.
- b. 4 raste në RNM “Kune Vain Tale” nga erozioni detar janë shkukur 2 pemë të llojit Pishë dhe dëmtimi i objektit të vrojtimit.

- c. 1 rast në RNM “Patok Fush Kuqen Ishëm” nga erozioni detar janë shkukur 2 pemë të llojit Pishë.
- d. 1 rast në RNM “Berzane” i dëmtimit të zonës së mbrojtur nga shkaqet natyrore (shirat dhe erërat e forta) në fshtatin Berzanë rezulton se është gërryer 30m² sipërfaqe ku janë dëmtuar (rrëzuar) 9 copë pemë të llojit Lis dhe Shqopë.

➤ **Monitorimi i Gjuetisë:**

Gjatë kontrolleve të ushtruara në periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **8 raste** të gjuetisë së paligjshme (Peshkim), ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku 7 raste pa autor dhe 1 raste me autor.

- a. 6 raste në RNM “Kune Vain Tale” ku janë sekuestruar 14 copë të mjeteve lundruese dhe 500 ml rretë peshkimi.
- b. 2 raste në RNM “Patok Fush Kuqen Ishëm” ku janë ndërtimi i 2 copë ujshjezëja dhe 1 ndërtim ure druri.

➤ **Ndotja e Mjedisit:**

Gjatë kontrolleve të ushtruara për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **6 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku 4 raste pa autor dhe 2 raste me autor.

- a. 4 raste në RNM “Kune Vain Tale” ku kemi ndodje të ujit në Kënetën e Merxhanit, shkarkime të elementëve të bëtonit dhe hedhje të mbeturinave inertesh.
- b. 1 rast në RNM “Patok Fush Kuqen Ishëm” ku në një sipërfaqe prej 60 m² janë hedhur një sasi mbetjesh të ngurta
- c. 1 rast në RNM “Berzane” ku janë hedhur mbeturash në një sasi prej 3 m³.

Në total nga AdZM-ja e qarkut Lezhë janë mbajtur 21 proces-verbale konstatimi nga këto 17 raste pa autor dëmi dhe 4 raste me autor dëmi ose 19 % e rasteve me autor dëmi

11. Qarku Vlorë

Për periudhën Janar- Dhjetor 2016 janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **5 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit pa autor.

- a. 2 raste në RNM “Rrëzomë” ku janë prerë 123 copë pemë të llojit Gështenjë në ekonominë pyjore “Rrëzomë”.
- b. 3 raste në PM “Vjosë Nartë” ku janë prerë 13 copë pemë të llojit Pishë.

➤ **Kullotje pa leje**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **2 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, me autor dëmi.

- a. 2 raste në PK “Butrint”

➤ **Monitorimi i ndërhyrjeve dhe dëmtimeve në zona të mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar 4 raste, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, nga shkaqe natyrore.

- 1 rast në PK “Butrint” ku 1 rast është rrëzimi i një pemë nga erërat, 3 raste në PM “Vjosë Nartë”, ku nga erërat e forta ku janë rrëzuar 25 pemë të llojit Pishë.
- **Mbrojtja nga Zjarret:**

Për periudhën Janar- Dhjetor ka patur **8 raste** të rënies së zjarrit, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit pa autor.

- a. 2 raste në PK “Butrint” ku kemi patur përshkrim të sipërfaqes nga zjarrit prej 0.36 Ha.
- b. 3 raste në RNM “Karaburun”, ku kemi patur përshkrimme sipërfaqes nga zjarrit 14.06 Ha.
- c. 3 raste në PM “Vjosë Nartë”, ku kemi patur përshkrimme djegie nga zjarri të sipërfaqes prej 420 Ha e përshkruar dhe 213.5 Ha e djegur.

➤ **Zënie të fondit pyjor:**

Për periudhën Janar- Dhjetor ka patur **4 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit me autor.

- a. 2 rast në PM “Vjosë Nartë” ku është zënë një sipërfaqe prej 40 m² për ndërtim e një kashtoreje dhe rrethim gardhi.
- b. 2 raste në MN “Delta e Përroit të Palasë”, ku janë zënë një sipërfaqe prej 158 m².

➤ **Ndotja e Mjedisit:**

Gjatë kontrolleve të ushtruara për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar 3 raste, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit pa autor.

- a. 2 raste në PM “Vjosë Nartë” ku kemi ndotje të bregdetit ranor në 300 m.
- b. 1 rast në PK “Butrint” ku kemi hedhje të mbeturinave urbane.

Në total nga AdZM-ja e qarkut Vlorë janë mbajtur 21 proces-verbale konstatimi nga këto 15 raste pa autor dëmi dhe 6 raste me autor dëmi ose 29 % e rasteve me autor dëmi

12. Qarku Kukës

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar këto raste:

➤ **Monitorimi i prerjeve të paligjshme në Zonat e Mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar **8 raste**, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit, ku 5 raste pa autor dhe 3 raste me autor.

- a. 1 rast në RNS “Lumi i Gashit” ku janë prerë 12 pemë të llojit Ah në ekonominë pyjore “Lumi i Gashit”.
- b. 7 raste në PN “Korab Koritnik” ku janë prerë 404 pemë e llojeve Shkozë, Pishë, Ahu dhe Mështek në ekonominë pyjore “Gjallicë, Bicaj Kolesjan, Shishtavec, Zapod”.

➤ **Monitorimi i ndërhyrjeve të dëmtimeve në zona të mbrojtura:**

Për periudhën Janar- Dhjetor janë konstatuar 4 raste, ku për këto raste janë mbajtur proces verbalet e konstatimit të dëmit.

- a. 3 raste në PN “Korab Koritnik” ku nga shkaqet natyrore (ngrixat, erërat e forta) kemi dëmtim të bimeve medicinale të llojit Boronicë në një sipërfaqe prej 150 Ha, rrëzimin e 182 copë pemë të llojeve Pishë e Mështek në.

b. 1 rast në RNM “Tej Drini i Bardhë” ku nga erërat e forta janë rrëzuar 2 pemë të llojit Ah.

➤ **Mbrojtja nga Zjarret:**

Për periudhën Janar- Dhjetor ka patur **1 rast** të rënies së zjarrit ku është mbajtur proces verbali i konstatimit të dëmit pa autor.

a. në PK “Lugina e Valbonës” ku kemi patur përshkrim të sipërfaqes së zjarrit prej 4.5 Ha në ekonominë pyjore “Çerem Dragobi”.

Në total nga AdZM-ja e qarkut Kukës janë mbajtur 15 proces-verbale konstatimi nga këto 11 raste pa autor dëmi dhe 4 raste me autor dëmi ose 27 % e rasteve me autor dëmi

Në total janë mbajtur 216 proces-verbale konstatimi nga AdZM-të e qarqeve, të cilat nga këto 75 proces verbale janë me autor dëmi dhe 141 janë pa autor dëmi ose në raport përqindje shkalla e evidentimit të autorit të dëmit është 35%.

Problematikë

Në lidhje me dërgimin e informacioneve nga AdZM e rretheve të ardhura pranë sektorit të monitorimit në AKZM për disa qarqe jo vetëm është sjellë me vonesë por dhe jo i saktë ku numri i proces-verbaleve të mbajtura nuk rakordon me ato të pasqyruar në informacionet përkatëse, mund të përmendim AdZM-ja Dibër, Vlorë, Shkodër, Elbasan dhe Gjirokastër.

Kemi vënë re se disa AdZM për disa probleme që hasin në punën e përditshme sjellin informacion pranë AKZM-së dhe e quajnë të zgjidhur problemin, duke mos propozuar zgjidhje si AdZM-ja Dibër, Gjirokastër.

Do të ishte më mirë që cdo propozim të vinte nga AdZM-të të cilët janë më në brendësi të detyrave të tyre në punën e përditshme dhe si rrjedhojë dhe ndihma jonë në zgjidhjen e problemeve do të ishte më konkrete.

Në lidhje me bashkëpunimin me instucionet e tjera shtetërore nuk është bërë aq sa duhet, gjithnjë kjo sipas informacioneve të sjella pranë sektorit të monitorimit në AKZM sidomos me ISHMP-të rajonale në qarqe, ku mund të themi se në disa qarqe ka qenë inekzistent, sidomos ai i Qarkut Durrës, kjo jo për fajin e AdZM-së por për mos bashkëpunimin e inspektorëve të ISHMP-ve rajonale.

Për këtë nga ana jonë është vënë disa herë në dijeni ISHMP qendror, i cili ka detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me institucionet shtetërore, por nuk është arritur ndonjë zgjidhje konkrete. Nuk kemi ndonjë dokument konkret të hartuar (detyruet), për të përcaktuar detyrat e detyrimet në lidhje mbi bashkëpunimin në mes dy instuticioneve, ku edhe një akt marrëveshje që u hartua nga ana jonë dhe nga ISHMP-ja nuk u arrit të miratohej nga ISHMP-ja për të cilin nuk u dha asnjë shpjegim.

Për këtë problem edhe pse nga sek. i monitorimit në AKZM u hartua një draft bashkëpunimi dhe pritej miratimi nga ana e ISHMP-së qendrore, ku në të cilin është synuar që të rritet bashkëpunimi reciprok i AKZM-së dhe ISHMP-së në nivel qendror dhe rajonal, nga ISHMP-ja nuk u miratua dhe për të cilin nuk u dha asnjë shpjegim.

Në bazë të të gjithave informacioneve të ardhura nga AdZM-të e qarqeve për problematikat e hasura, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016 nga Sektori i Monitorimit të AKZM-së janë kryer kontrolle në AdZM-të e të gjitha Qarqeve.

Me urdhër inspektimi të Drejtorit të Përgjithshëm Z. Zamir DEDEJ është kryer inspektim në AdZM-të e qarqeve me objekt sipas problematikave dhe zbatimit të planit të punës dhe konkretisht:

Në AdZM-në e Qarkut Tiranë janë kryer 10 inspektime;

Në AdZM-në e Qarkut Dibër janë kryer 4 inspektime;

Në AdZM-në e Qarkut Elbasan janë kryer 4 inspektime;

Në AdZM-në e Qarkut Fier janë kryer 1 inspektim;

Në AdZM-në e Qarkut Shkodër janë kryer 4 inspektime;

Në AdZM-në e Qarkut Durrës janë kryer 1 inspektim;

Në AdZM-në e Qarkut Berat janë kryer 2 inspektime;

Në AdZM-në e Qarkut Gjirokastrë janë kryer 2 inspektime;

Në AdZM-në e Qarkut Kukës janë kryer 1 inspektim;

Në AdZM-në e Qarkut Lezhë janë kryer 3 inspektime;

Në AdZM-në e Qarkut Vlorë janë kryer 6 inspektime;

Në AdZM-në e Qarkut Korçë janë kryer 2 inspektime;

Pësa i përket punës së sektorit të monitorimit në AKZM, fokusimi ynë ka qenë kryesisht në monitorimin e plotësimit të detyrave të sek. të monitorimit në cdo AdZM sipas planit të punës,

detyrave të lëna për plotësim nga grupet e monitorimit sipas problematikave të konstatuara në terren.

Në krahasim me vitin 2015 problematikat në përgjithësi kanë qenë më të pakta dhe në shumtën e rasteve kanë marrë zgjidhje.

Problematikat që janë konstatuar për këtë periudhë të vitit 2016 kryesisht kanë qenë në :

➤ **Zbatimin e planit të punës dhe orarit nga punonjësit të AdZM-ve.**

Nga monitorimi i Sektorit të Monitorimit janë konstatuar raste ku personeli i AdZM-ve nuk është gjendur në punë, rojet mjedisore nuk kanë zbatuar planin e punës.

Për këtë janë marrë masa me vërejtje, paralajmërim e deri në largim nga puna.

- **AdZM-ja Gjirokastrë**

Mos zbatimi i planit të punës nga rojet mjedisore dhe mos paraqitja në punë janë propozuar për masa për 3 punonjës.

- **AdZM-ja e Elbasanit.**

Mos zbatimi i planit të punës nga rojet mjedisore dhe mos paraqitja në punë janë propozuar për masa për 3 punonjës.

- **AdZM-ja e Fierit**

Mos zbatimi i planit të punës nga rojet mjedisore dhe mos paraqitja në punë janë propozuar për masa për 3 punonjës.

- **AdZM-ja Tiranë**

Mos zbatimi i planit të punës nga rojet mjedisore dhe mos paraqitja në punë janë propozuar për masa për 6 punonjës.

- **AdZM-ja Lezhë**

Mos zbatimi i planit të punës nga rojet mjedisore dhe mos paraqitja në punë është propozuar për masë për 1 punonjës.

- **AdZM-ja Shkodër**

Mos zbatimi i planit të punës nga rojet mjedisore dhe mos paraqitja në punë është propozuar për masë për 1 punonjës.

- **AdZM-ja Durrës**

Mos zbatimi i planit të punës nga rojet mjedisore dhe mos paraqitja në punë është propozuar për masë për 1 punonjës.

Vlen për tu përmendur fakti se në të gjitha rastet nga titullarët e AdZM-ve nuk evedintohen këto shkelje nga punonjësit e tyre por nga ana jonë.

➤ **Mos plotësimi i detyrave të lëna nga grupet e monitorimit dhe mos raportimi pranë AKZM-së:**

- **AdZM Vlorë**

Detyrat e lëna nga monitorimi i grupit të punës nga AKZM-ja: nuk sjellin informacion mbi masat e marra prej tyre për zgjidhjen e problemeve të konstatuara si rasti i postoblokut , rasti i aktiviteteve tregtare brenda MN Syri i Kaltër.

- **AdZM Gjirokastrë**

Detyra e lenë nga monitorimi i grupit të punës nga AKZM-ja: nuk sjellin informacion mbi masat e marra prej tyre për zgjidhjen e problemeve të konstatuara si ai i rastit të HEC-it në Çarçovë për të cilin nuk kemi asnjë raport përfundimtar për bllokimin e tij për arsye të mos paraqitjes së dokumentave mbi ligjshmërinë e tij.

- **AdZM-ja Lezhe**

Postobloku në hyrje të Kune Vain plotësimi i dokumentacionit kishte mangësi pasi nuk ishte plotësuar cdo ditë dhe librat e shërbimit nuk ishin të përshtatshëm. Për këtë nga ana jonë u përgatitën librat e shërbimit sic janë përgatitur për AdZM-të e tjera dhe u dërguan pranë AdZM-së Lezhë, ku në të, do të hidhen nga punonjësit e shërbimit numri i makinave dhe vizitorëve si dhe shuma e lekëve për çdo turn.

- **Mbi problemin e komunikimit të AKZM-së me AdZM-të mbi shkëmbimin e informacioneve, vërehet një mos korrektësi apo neglizhencë duke penguar e vonuar plotësimin e detyrave të ngarkuara.**
- **Në kuadrin e bashkëpunimit me task-forcën Roja e Gjelbër vetëm Qarku Durrës ka sjellë informacion në kuadër të bashkëpunimit, ndërsa Qarqet e tjera nuk kanë sjellë asnjë informacion.**
- **Nga monitorimi i rrjeteve sociale rezulton se janë dhënë shumë pamje të ndryshme si gjuetisë dhe shfrytëzimit të pyjeve brenda ZM, konkretisht:**
 - **Në qarkun e Korcës**

Nga rrjetet sociale jepen pamje të reklamimit të gjahut të vrarë në mënyrë të kundraligjshme si dhe prerje e transport të lëndës drusore brenda ZM.

Në qarkun Librazhd

Herë pas here jepen pamje në rrjetet sociale të transportit të lëndës drusore.

Në Qarkun e Kukësit

Jepen pamje të rënda të vrasjes së një ariu nga banorët e një zone.

Në Qarkun e Lezhës

Në datën 5.11.2016 nga një person i quajtur Agron Poisteri në ZM Kune Vain Lezhë raportohet se kryhet gjueti e pa ligjshme.

Në të gjitha rastet e lartpërmendura nga Përgjegjës të monitorimit të këtyre qarqeve nuk raportojnë por vihen në lëvizje nga ana jonë vetëm kur u kërkohet një gjë e tillë.

Për këtë duhet që pranë cdo AdZM-je, një nga specialistët e monitorimit të ngarkohet për të monitoruar rrjetet sociale për problemet e lart përmendura.

Në kuadër të inisiativës për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të konstatuara në terren vërehet dhe kërkohet që zgjidhja e tyre të vijë nga AKZM-ja dhe jo nga vetë AdZM-ja.

Problem tjetër mbetet mbajtja e proces-verbaleve të dëmeve pa autor dëmi. Duke e krahasuar me vitin 2015 ka një përmirsim por jo shumë i dukshëm dhe konkretisht:

Për vitin 2015 janë mbajtur 280 proces verbale konstatimi, nga këto 67 me autor dëmi ose 24%

Për vitin 2016 janë mbajtur 216 proces verbale konstatimi, nga këto 75 me autor dëmi ose 35%

Në të gjitha rastet Sektori Monitorimit, ka kryer monitorime në mënyrë të pavarur, nga pikëpamja profesionale, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit.

Objektivat për të ardhmen:

Qëllimi kryesor i punës së sektorit të monitorimit në AKZM do të jetë kontrolli, inspektimi për të evidentuar të gjitha problemet në çdo AdZM dhe adresimi i tyre për zgjidhje në funksion të përmirësimit e menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas kërkesave dhe standarteve ndërkombëtare dhe eksperiencës së vendeve europiane, duke ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore në to.

- Të ushtrohet kontrolle të vazhdueshme për parandalimin e dëmtimeve në zonat e mbrojtura.
- Në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit dhe projekteve të punohet për identifikimin e të gjitha veprimtarive private brenda zonave të mbrojtura dhe bllokimi i veprimtarive që bien ndesh me ligjin e zonave të mbrojtura dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij.
- Të ushtrohen kontrolle të vazhdueshme për parandalimin e gjuetisë së paligjshme.
- Do të kryejmë një inventarizim dhe identifikim të aktiviteteve të ligjshme dhe të paligjshme në territoret e zonave të mbrojtura, problemeve madhore që lidhen me mirëfunksionimin e çdo zone dhe raportet me aktoret e tjera në zonë (peshkatarë, restorante, shërbime, organe vendore, etj.)

- Të hartohen programe pune të përbashkëta me ISHMP-në, Policinë e Shtetit, Inpektoriatin e Peshkimit, Pushtetin Vendor dhe me të gjithë Institucionet e tjera në funksion të mbrojtjes së biodiversitetit, mjedisit, pyjeve, kullotave brenda zonave të mbrojtura.
- Kontrolle në AdZM-të e qarqeve për plotësim të saktë të dokumentacionit dhe zbatueshmërisë ligjore për zonat e mbrojtura.
- Do të vazhdojë monitorimi dhe evidentimi i rasteve të mbajtjes së kafshëve të egra në robëri dhe gjetja e mundësive për rehabilitimin e tyre në qendrat e ndërtuara në vendet fqinje.
- Do të organizojmë trajnime të specialistëve dhe rojeve mjedisore në fushat e inspektimit dhe në mbrojtjen së ZM nga zjarri me qëllim rritjen e kapaciteteve të çdo anëtari të stafit të administratës së ZM-ve, që ato të jenë në gjëndje të zbatojnë detyrat e tyre me standarte të larta, duke përdorur përqsasje moderne në fushën e që mbulojnë.

Rekomandime

- Të gjendet mundësia e financimeve për disiplinimin e post-bloqeve (Trau) në hyrje të ZM në qarqet Tiranë (Dajt), Vlorë (Syri i Kaltër) dhe Lezhë (Kune Vain) mbi vjeljen e të ardhurave nga mjetet e vizitorët, me anë të trarëve dhe pajisjeve elektronike për të bërë të mundur monitorimin e tyre dhe shmangjen e abuzimeve.
- Të kryhen procedurat e vjeljes së vlerës së dëmit nga proces verbalet e mbajtura në ZM.
- Çdo AdZM në mënyrë të vazhdueshme të raportojë pranë sektorit të monitorimit në AKZM për të gjitha aktivitetet, projektet mbi zbatimin e ecurinë e tyre, të realizuar me fondet shtetërore apo private në ZM.

Ju faleminderit.